

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË  
27 SHTATOR 2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE  
27. SEPTEMBRA 2007. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBER

2007

## RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 14 e 17 shtatorit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin civil;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin;
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për parqet nacionale;
13. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

## DNEVNI RED

1. Usvajanje Zapisnika sa plenarne sednice od 14 i 17 septembra 2007. godine;
2. Vreme za poslanička pitanja;
3. Prvo razmatranje narta Zakona za upotrebu državnih simbola Kosova;
4. Prvo razmatranje narta Zakona o poljoprivrednoj inspekciji;
5. Prvo razmatranje narta Zakona o diplomskom ispit u mature;
6. Prvo razmatranje narta Zakona o Ministarstvu spoljnih poslova i diplomatskoj službi Kosova;
7. Prvo razmatranje narta Zakona o statusu, imunitetu i privilegijama diplomatskih i konzulskih misija i njihovog osoblja na Kosovu i vojno međunarodno prisustvo kao i njegovo osoblje;
8. Drugo razmatranje narta Zakona o izmeni i dopuni Zakona o registrima civilnog statusa;
9. Drugo razmatranje narta Zakona o civilnom statusu;
10. Drugo razmatranje narta Zakona o trgovackim društvima;
11. Drugo razmatranje narta Zakona o mestu stanovanja i mestu boravka;
12. Razmatranje preporuke Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, seoski razvoj, životnu sredinu i prostorno planiranje u vezi prosleđivanja narta Zakona o nacionalnim parkovima;
13. Razmatranje predloga za izmenu i dopunu Poslovnika Skupštine Kosova.

## AGENDA

1. Approval of the minutes of the plenary session of 14 and 17 September 2007;
2. Time for parliamentary questions;
3. First reading of the Draft Law on use of state symbols of Kosovo;
4. First reading of the Draft Law on agricultural Inspection;
5. First reading of the Draft Law on final and mature exam;
6. First reading of the Draft Law for the Ministry of Foreign Affairs and Diplomatic Service of Kosovo;
7. First reading of the Draft Law for the status, immunity and privileges of diplomatic missions, Consular and the personnel in Kosovo and international army presence, as well as its personnel;
8. Second reading of the Draft Law for amendments and additions of the Law on civil status registers;
9. Second reading of the Draft Law on civil stratus;
10. Second reading of the Draft Law on trade societies;
11. Second reading of the Draft Law on dwelling and emplacement;
12. Discussion of the recommendation of the Committee for Agriculture, Forestry, Rural Development, Environment and Spatial Planning regarding the Draft Law on national parks;
13. Review of the proposal for amendments and additions of the Rule of procedure of the Assembly.

Seancën plenare të Kuvendit, e kryesoi **Sabri HAMITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Seanca filloj punën në orën 10,00

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kolegë të nderuar,  
Ju shpreh mirëseardhje në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Përshëndes zëvendëskryeministrin dhe ministrat e Kabinetit të Qeverisë së Kosovës dhe të tjerët, që e përcjellin këtë seancë.

Momentalisht, në sallë janë të pranishëm 72 deputetë, që do të thotë se mund të fillojmë punën dhe të vendosim për pikat që i kemi në rend dite.

Në fillim, dua t'ju njoftoj se, në bazë të Rregullës 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në konsultim dhe në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, në mënyrë konsensuale ka përgatitur rendin e ditës, të cilin ju e keni marrë, dhe deri më tash nuk kemi pasur asnjë plotësim me shkrim të agjendës.

Fjalën e ka kërkuar Bajrush Xhemajli. Bajrush, lidhur me rendin e ditës?

BAJRUSH XHEMAJLI: Zoti kryesues,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Kam dalë këtu për një çështje të ngutshme, për të kërkuar të sqarohet transferi i një milion eurove nga ana e zotit Ryecker në favor të AKM-së përkundër asaj se ky Kuvend, në seancën e kaluar ka votuar ndryshe.

Në fakt, ende pa debatuar në Kuvend, zoti Ryecker e ka nënshkruar transferin e këtyre parave dhe ne kemi marrë vendim faktikisht post-festum.

Shtrohet çështja: si mund të zoti Ryecker që këto para të taksapaguesve, t'i ndajë sikur të ishin paratë e babait të tij?

Pyes zotin Ryecker: A e njeh Parlamentin e Kosovës, apo jo? Nëse e njeh, pse po tallet me të. Përgjegjës për këtë janë edhe ministri i Financave edhe ministri i Energetikës dhe i Minierave. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Xhevati Bislimi.

**XHEVAT BISLIMI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Zotërinj deputetë,

Unë sot do të ngris një çështje që mendoj se është dashur të ngritet dhe të kryhet kaherë, por meqë jemi të vonuar, duhet të paktën para se ta mbarojë mandatin ky Kuvend, të hartojë një plan për Kosovën, ta bëjë publik këtë plan dhe në këtë plan të saktësitet çfarë do të bëjë Kosova pas 10 dhjetorit.

Ne, aktualisht, jemi pa asnjë plan. Të tjerët kanë bërë shumë plane për Kosovën, por Kosova nuk ka asnjë plan të vetin – çfarë do të bëjë pas 10 dhjetorit. Prandaj, unë insistoj që ky Kuvend ta vë në rend dite këtë çështje dhe ta ndërtojë një plan të tillë që do të obligonte të gjitha institucionet e Kosovës dhe çdo qelizë të shoqërisë në Kosovë. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Pos këtij rendi të ditës, ju njoftoj se është edhe kërkesa e Kuvendit të Kosovës që ministri i Brendshëm të japë një informatë për situatën e sigurisë në Mitrovicë, pas ndodhive të paraqitura nga deputeti Kelmendi.

Po ashtu, ju njoftoj se ne, dje – mbrëma, kemi marrë një informatë nga Ministria e Punëve të Brendshme, por nuk e kemi vë në rend dite, sepse proceduralisht nuk ka mund të përkthehet dhe të kalojë procedurat e rregullta të Kuvendit. Ai teksti i informatës ka arritur në Kuvend dje pasdite.

Unë mendoj se mund të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

- **Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 14 dhe 17 shtator 2007**

Pyes, a ka kush vërejtje?

Nuk ka.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

## - Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e paraparë, janë parashtuar pesë pyetje parlamentare, të cilat nuk kanë arritur të procedohen për t'u radhitur për seancën e sotme dhe ato do të radhiten për seancën tjeter.

Ju njoftoj se pyetjet, për të cilat nuk është dhënë përgjigje për dy seanca të njëpasnjëshme, janë botuar në Buletinin e Kuvendit, sipas Rregullores në fuqi.

Deputeti, Hydajet Hyseni-Kaloshi, ka pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Pushtetit Lokal, zotri Lutfi Haziri.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni-Kaloshi.

**HYDAJET HYSENI-KALOSHI:** Faleminderit zoti kryesues!

Unë, megjithatë, dua të sqaroj që në fillim. Pyetjen ia kam drejtuar Qeverisë dhe ministrike përkatëse. Është pyetje që ka të bëjë me shumë ministri. Megjithatë, konsideroj krejt në rregull që zëvendëskryeministri të japë përgjigje.

Pyetja ka të bëjë me problemet që janë adresuar dhe i kanë ngritur në shumë raste banorët e cepit jugor të Kosovës – të Restelicës me rrëthiminë, siç janë:

- Mungesa e sinjalit televiziv të Televizionit publik dhe repetitorëve të nevojshëm për mbulimin e kësaj pjese me valë të televizioneve tonë;
- Mungesa e lidhjeve telefonike;
- Rruga e dëmtuar, pjesërisht e arnuar, por jo e rregulluar siç ka qenë
- planifikuar;

(Ndërprerje nga ana e regjisë)

**KRYESUESI:** Ia zgjatni kohën edhe pak. Hydajet, dije se e ke vetëm edhe një minut!

**HYDAJET HYSENI-KALOSHI:** Po e lexoj pyetjen!

**KRYESUESI:** Po, lexoje pra!

**HYDAJET HYSENI-KALOSHI:**

- Pamundësia e qarkullimit automobilistik tejkufitar me fshatrat fqinje në Shqipëri;
- Pamundësia e shitjes së prodhimeve bujqësore e blegtoriale, si dhe
- Mungesa e kushteve për mësim edhe të gjuhës shqipe në shkollë, me gjithë kërkesat e qytetarëve për të mësuar edhe në gjuhën shqipe.

Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** E ka fjalën Zëvendëskryeministri, Lutfi Haziri.

**LUTFI HAZIRI:** Faleminderit!

Inderuari kryesues,  
Të nderuar deputetë,  
Unë në njëren nga seancat e kaluara kam bërë përgjigjen me shkrim, duke afruar detaje e shënime konkrete rreth angazhimit të Qeverisë për Komunën e Dragashit, që mbulon edhe sferat e interesimit që paraqet deputeti Hyseni, duke afruar fakte të investimeve nga Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, bashkëfinancimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe i komunës së Dragashit. Besoj se gjatë kësaj dite, gjatë kësaj seance, do t'i përsëris edhe njëherë këto fakte.

Pjesa e dytë ka të bëjë me mbulimin e komunës së Dragashit me sinjalin e RTK-ës. Gjatë bisedave të vazhdueshme me menaxhmentin e RTK-ës dhe me organizatën e cila është e licencuar për shtrirjen dhe mbulimin me sinjal televiziv të RTK-së, ne presim që brenda këtij viti të vendoset repetitor, të vendosen mjetet e domosdoshme dhe të fillojë të mbulohet kjo pjesë e territorit të Kosovës, por që është kompetencë ekskluzive e një organizate që është e licencuar dhe që punon në emër të institacioneve të Kosovës.

Sa u përket angazhimeve që kanë të bëjnë me minoritetin goran, në veçanti angazhimet konkrete të Qeverisë, ministri i Shëndetësisë, Sadik Idriz, do të japë të dhëna tjera konkrete.

Zoti kryesues, nëse më lejoni, në fund të kohës për pyetje dhe përgjigje, unë do të doja edhe një herë të ofroj shënimet për zotin Hyseni. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Sadik Idriz, përgjigjet për pyetjen e njëjtë.

SADIK IDRIZ: Poštovani poslaniče Hyseni!

Restelica je jedno od najvećih sela na Kosovu koje ste vi posetili, a u kojem ja živim. Znači, u susedstvu i pripada zoni u kojoj smo mi, znači moja grupacija, koalicija Vakat i u svim ovim izborima ima najveću podršku glasača.

Samo da napomenem one probleme koje ste pomenuli. Put je u završnoj izgradnji i mi smo sa ministrom Ahmetijem bili gore i presećena je vrpca kada je počela izgradnja i ona je u završnoj fazi. To je jedna investicija koja je iznad milion eura i to je najveća investicija nakon rata u opštini Dragaš i kada ste vi bili verovatno je bio započeo put i to je nešto što smo odradili.

Kada je u pitanju telefonija, Mobilna telefonija je znači završena. Takodje, ima i govornica u selu, a RTK je problem koji nije samo za Restelicu, nego za čitavu opštinu Dragaš i to je pitanje sa kojim se suočavamo nekoliko godina, plus je naplata 3,5 eura koja ide preko računa za strujomere.

Put prema Albaniji. Otvorena su dva granična prelaza, jedan kod Kruševa, ali nisu prelazi za automobile, nego za ljudet, jer to su kompetencije drugih, nisu naše kompetencije i nema ni Kosovo kompetencije, to je UNMIK i da kažem da institucije Kosova nemaju i tu je ta komunikacija normalna, ali ne i automobilma.

Drugi je problem put prema Makedoniji. Otvoren je i granični prelaz, ali ograničen sa nekoliko sela i tu je opet pitanje kompetencija što nije otvoren normalan granični prelaz prema Makedoniji jer je Restelica trgovala sa Makedonijom i to je problem koji postoji.

Što se tiče škole, nastava se izvodi na bosanskom jeziku i 680 je učenika. Otvorena su odeljenja i na albanskem jeziku za one roditelje koji su nakon rata izrazili želju... i to pitanje je rešeno.

Možda ste vi bili zabrinuti zato što je Restelica na nadmorskoj visini iznad 1.400-1.500 metara visine. Problemi koji su vam izneti, moguće je da su pojedinačno odgradjeni, ali ja znam da smo mi za Restelicu radili u ovom mandatu, u trogodišnjem mandatu. I nikada, u istoriji, Restelica nije više dobila. Uradili smo ambulantu, uradili smo repetitor, uradili smo put, uradili smo povećanje seoskih ulica i tako dalje. To znaju i gradjani Restelice i cene ovo što smo mi i ova Vlada uradili.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ministër!  
Zoti Hyseni, a keni për të shtuar diçka?

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Falënderoj ministrat për përgjigjen! Përgëzoj edhe për punët që janë bërë.

Megjithatë, do të dëshiroja, parmisht - a konsideron Qeveria se komunitetet në Kosovë, komunitetet numerikisht pakicë në Kosovë, kanë dhe duhet të kenë trajtim të njëjtë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për ministrin Bujar Dugolli. Ministri Dugolli nuk është këtu. Pyes deputetin, a dëshiron ta lexojë pyetjen, edhe pse ministri s'është këtu, sepse e ka të drejtën ta bëjë këtë.

RAMADAN KELMENDI: Nuk do t'ju merrja kohë, do të doja që ministri të përgjigjet.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ramadan Kelmendi!  
Deputeti Xhevati Bislimi ka pyetje për ministren Melihate Tërmkollin. Urdhëroni, zoti deputet!

XHEVAT BISLIMI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Fjala është për regjistrimin e popullsisë në Kosovë. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë nuk është bërë që nga viti 1981. Pas luftës, është premtuar shumëherë se do të bëhet regjistrimi i popullsisë, por deri më sot nuk u bërë.

Institucionet e përkohshme, të krijuara nga UNMIK-u kanë bërë regjistrimin ose matrikullimin e bagtisë në Kosovë, por nuk po e bëjnë regjistrimin e popullsisë.

Pyetje:

- Meqë ju jeni edhe kryetare e Komisionit për regjistrimin e popullsisë, a mund të na thuani, cilat janë ato forca, ato qarqe ose ata faktorë e aktorë që po e pengojnë regjistrimin e popullsisë në Kosovë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!  
E ka fjalën zonja ministre, Melihate Tërmkollin.

**MELIHATE TËRMKOLLI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Njëkohësisht unë falënderoj zotin Bislimi për pyetjen e shtruar dhe kujtoj se është në interes të përgjithshëm një informacion i tillë, ani pse në debatin e kaluar mendoj se e kam dhënë një pjesë të madhe të informacioneve rreth kësaj çështjeje.

Është e vërtetë se ka pasur dhe ka disa hezitime rreth përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë. Në fakt, përpjekjet fillimisht për mbajtjen e regjistrimit dhe për fillimin e përgatitjeve, nuk janë shumë të hershme, sepse në mandatin e parë, tek në fund të vitit 2004 është përgatitur Ligji për regjistrimin e popullsisë, ndërsa që nga shkurti i vitit 2005, ne kemi filluar përgatitjet për regjistrim.

Mund të them se ka pasur një hezitim të mekanizmave ndërkombëtar dhe vetëm pas një insistimi të madh që kemi bërë dhe një dinamike shumë të madhe, kur kemi bërë përgatitjet, atëherë kemi pasur edhe kryçjen e tyre pas hezitimeve, fillimisht, të cilat janë bërë me një këmbëngulje të madhe të tyre, por edhe një këmbëngulje jona për t'i bërë përgatitjet për regjistrim.

Natyrisht, përgatitjet e plota ne i kemi deklaruar edhe para Kuvendit të Kosovës, edhe para institucioneve të tjera dhe kemi pasur një propozim të Entit të Statistikës, bashkë me Ministrinë e Shërbimeve Publike, që regjistrimi të mbahet në nëntor të vitit 2007.

Kemi parasysh, po ashtu, edhe Pakon e Presidentit Ahtisari, që në njëfarë mënyre ka legjitimuar standarde të dyfishta për regjistrimin e popullsisë dhe, po ashtu, i kam bërë shumë të qarta edhe këto në Kuvendin e Kosovës.

Ne kemi pasur debatin dhe në atë debat kam kërkuar që të përcaktohet, me gjithë faktin që e kemi dokumentin e Ahtisarit, por kemi edhe një fakt tjeter që ende nuk e kemi si dokument të pranuar ndërkombëtarisht dhe nëse kemi lejuar dhe pranuar që, edhe përkundër këtij dokumenti, të mbahen zgjedhjet dhe të caktohet vendimi për zgjedhje, pse të mos bëhet edhe ai për regjistrimin e popullsisë. Ende nuk ka një vendim nga Parlamenti i Kosovës dhe unë edhe më tutje pres që të ketë vendim nga Parlamenti i Kosovës për caktimin e datës së mbajtjes së regjistrimit të popullsisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Ministre!

Xhevati Bislimi, a ka të shtojë diçka?

**XHEVAT BISLIMI:** Çështja e regjistrimit të popullsisë nuk është vetëm çështje demografike, çështje statistike, por është edhe çështje politike, çështje sociologjike, ekonomike e të tjera. Prandaj, unë mendoj që të paktën ky popull, duhet ta ketë tretmanin, trajtimin e këtyre kafshëve që i kanë regjistruar.

Nuk e di si mund të organizohen zgjedhjet e pesta me radhë pa u regjistruar popullsia. Dhe, pse ky Kuvend, pse kjo Qeveri, pse këto institucione pranojnë këtë status, këtë poshtërim që u bëhet nga qarqe të caktuara, nuk po them nga bashkësia ndërkombëtare, absolutisht, por nga qarqe të caktuara, nga segmente të caktuara ndërkombëtare. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet!

Pyetje s'ishte, por ishte koment!

Kalojmë tutje.

Deputeti Fetah Berisha, ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku.  
Zoti deputet, Kryeministri s'është këtu. A doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni!

FETAH BERISHA: Të nderuar deputetë!

Pyetjen ia kam shtruar Kryeministrat ose ministritë përkatëse.

Vendi i quajtur Verrat e Llukës, i cili ka vlera historike, ku janë mbajtur kuvendet kombëtare dhe Kuvendi i pajtimeve të gjaqeve, ku patën marrë pjesë atëherë rrëth 500.000 vetë, tashmë është shndërruar në deponi të plehrave dhe mbeturinave. Për këtë ka informacione të sakta. Për këtë ka reaguar edhe Shoqata e Historianëve të Deçanit, ka reaguar edhe Asambleja Komunale e Deçanit.

Tanimë e dimë që Ligji për trashëgiminë kulturore është aprovuar në këtë Kuvend, i cili siguron mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike.

Pyetja:

- Kur do të vihet nën mbrojtjen e ligjit vendi i kuvendeve të mëdha kombëtare, vendi i pajimeve të gjaqeve, vlera jonë e trashëgimisë historike -Verrat e Llukës?  
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për leximin e pyetjes!

Deputetja Sala Berisha-Shala ka pyetje për zëvendësministrin Tomë Hajdaraj. Zëvendësministri Tomë Hajdaraj s'është këtu. Zonja deputete, a doni ta lexoni pyetjen, apo doni ta lëni kur të jetë ai këtu.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ka të bëjë me paqartësitë rrëth kompetencave në mes të nivelit lokal dhe atij qendoror sa i përket ndërrimit të destinimit të tokave.

Në qoftë se komuna e Drenasit nuk ndihmohet në zhvillimin e projekteve të tyre, atëherë duhet që Ministria përkatëse të mos nxitë ngatërresa, sepse ka raste të tilla kur Ministria lëshon pëlqime për parcela, kurse edhe komuna ka lëshuar më herët disa pëlqime për shfrytëzimin e atyre parcelave, kështu që atje ka nxitë ngatërresa në mes të njerezve.

Ndoshta ministri e dëgjon këtë pyetje, dhe do ta japë përgjigjen në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Deputetja Sala Berisha-Shala ka pyetje për ministrin Shatri, por ai nuk gjendet këtu. A do ta lexoni pyetjen? Urdhëroni, deputete!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

Pyetja ka të bëjë me shpenzimin e parave publike për shkollimin e shërbyesve civilë në institucionet private. Çka synohet me këtë strategji, të vihet universiteti publik në pozita të dobëta karshi shkollimit privat me shpërdorimin e parave publike?! Sa i kushton Qeverisë shkollimi i shërbyesve civilë në institucionet private?

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Deputetja Sanije Alijaj, ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku, i cili s'është këtu. Zonja deputete, a doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni!

SANIJE ALIJAJ: Po, do ta lexoj dhe mundësish le të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri. Përndryshe, nëse nuk është i gatshëm, kërkoj që përgjigjen....

KRYESUESI: Nuk ka - mundësish! Ti ia ke bërë pyetjen njeriut, i cili s'është këtu. Lexoje pyetjen, të lutem!

SANIJE ALIJAJ: Natyrisht!

Inderuari kryesues,

Të nderuar ministra dhe ju deputetë,

Kohë më parë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për kategoritë e luftës, të cilin, edhe pse me vonesë, e vlerësoj ndër ligjet më të rëndësishme sepse iu mundëson përkujdesje institucionale familjeve të atyre që dhanë jetën dhe gjymtirët për lirinë e Kosovës.

Pas luftës, në Kosovë ndodhën vrasje misterioze, që edhe sot e kësaj dite, nuk janë ndriçuar, ku pësuan përfaqësues institucionesh, siç ishin Xhemajl Mustafa, Ukë Bytyqi, Ismet Raci, Ismajl Hajdari, përfaqësues të Shërbimit Policor të Kosovës, që vlerësoj se janë dëshmorë të demokracisë, sepse ende luftojmë me mjete politike për pavarësinë e Kosovës.

Pyetja:

- Cilët janë hapat konkret të Qeverisë së Kosovës për t'i marrë në përkujdesje institucionale familjet e këtyre personalitetave të shquara që u vranë në vlugun më të madh të angazhimit të tyre për ta demokratizuar e bërë Kosovën shtet.

Për pyetjen e shtruar, kërkoj përgjigje me shkrim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Ne i trajtuam të gjitha pyetjet e deputetëve për Qeverinë.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 6 shtator 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministren Melihate Tërmkollit që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta bëjë prezantimin e Projektligjit. Urdhëroni, zonja Ministre!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nisur nga domosdoshmëria për përgatitjen e infrastrukturës ligjore, për funksionimin normal të shtetit të pavarur të Kosovës, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Qeveria e Kosovës, me dinamikë të shtuar, po realizojnë përgjegjësitë e tyre si në fushën e legjislacionit, ashtu edhe në fushat tjera.

Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore, është njëri nga projektligjet që përmbush këto kërkesa. Po ashtu, Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore është edhe kërkesë e paraparë në dokumentin e Presidentit Ahtisari, prandaj edhe në këtë kuptim Qeveria realizon një detyrë të saj.

Me Projektligj, simbolet shtetërore definoohen: flamuri, stema dhe himni i Kosovës.

Është e rëndësishme të potencohet se me këtë projektligj parashihet që forma e flamurit, përmasa e flamurit dhe e stemës, përbajtja e tekstit dhe partitura e himnit përcaktohen nga Kuvendi i Kosovës.

Projektligji përcakton mënyrën e përdorimit të simboleve shtetërore duke siguar një përdorim të dinjitetshëm, bazuar edhe në rregullat dhe standardet ndërkombëtare që përdoren edhe në vende tjera.

Projektligji trajton çështjen e përdorimit të simboleve shtetërore në pesë fusha apo pesë pjesë.

E para, lidhet me normat për qëllimin e ligjit, simbolet shtetërore, formën dhe përbajtjen e tyre.

Në pjesën e dytë, përcaktohet mënyra e përdorimit të flamurit shtetëror nga institucionet, përdorimi i flamurit shtetëror nga qytetarët, përdorimi i flamujve kombëtar dhe çështje tjera të kësaj natyre.

Pjesa e tretë, përmban rregulla për stemën, vendosjen, përdorimin dhe renditjen e stemës.

Në pjesën e katërt, janë rregullat për himnin e Kosovës, mënyrën e intonimit dhe renditja e intonimit të himnit, si dhe rregullat për përdorimin e simboleve shtetërore nga personat e tjerë juridikë.

Ndërsa, pjesa e pestë përmban masat dhe sankzionet në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji.

Projektligji, mund të them, është në pajtim me ligjet evropiane, të cilat rregullojnë këtë fushë.

Mjetet financiare, janë përllogaritur në 70 mijë euro për tri vitet e ardhshme dhe janë në suaza të mundësive buxhetore për zbatimin e Projektligjit.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj që të miratohet ky Projektligj në shqyrtimin e parë dhe të procedohet më tutje në procedura të mëtutjeshme. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Ministre!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e merr Nekibe Kelmendi.

**NEKIBE KELMENDI:** I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ministra,

Para nesh sot kemi për lexim të parë Projektligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës. Mendoj se, në këtë mënyrë, duke shtruar në procedurë parlamentare për miratim këtë ligj, ky Parlament hap pas hapi po përmbyll mozaikun e ligjeve, të cilat Kosovës po ia jepin identitetin e vet dhe subjektivitetin ndërkombëtar.

Mendoj se ky ligj është ligj i hartuar shumë mirë. Është një ligj i kuptueshëm, i qartë. Ka aty-këtu disa mangësi, për shembull kllapat nuk janë të preferueshme të përdoren në metodologjinë e hartimit të ligjeve. Me procedurën e mëtejshme gjatë amendamentimit, të gjitha kllapat do të fshihen.

Në pjesën shpjeguese, është thënë se "Ky ligj është në pajtueshmëri me ligjet e Bashkësisë Evropiane", mirëpo është përvjedhur gabim në gjuhën angleze dhe thuhet se "Është në pajtueshmëri me ligjet e UE", e kjo është çështje tjeter, që nuk çon peshë në përbajtjen e këtij ligji.

Ndoshta ishte dashur që edhe përkufizimet t'i ketë ky ligj, për shembull për flamurin. Është fjala për flamur shtetëror, për simbolet, është fjala për simbolet shtetërore, për himnin e tjera, e tjera. Sepse, siç rezulton nga brendia – përbajtja e ligjit, të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë që të përdorin edhe flamuj të tjerë, flamujt kombëtar.

Marrë në përgjithësi, është një ligj shumë i mirë dhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka kënaqësinë të deklarohet se e mbështet në tërsi këtë ligj. Në fazat e mëtutjeshme do të bëhen amendamente. Ndoshta do të duhej të parashikohen edhe disa dispozita ndëshkimore në rast se cenohet e drejta e përdorimit të flamurit kombëtar, shkelet apo përdoret në mënyrë denigruese flamuri shtetëror në vende ku nuk duhet të përdoret. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Kelmendi!

Fjalën e merr deputeti Hajredin Hyseni, besoj në emër të PDK-së.

**HAJREDIN HYSENI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,  
Ministra të pranishëm,  
Projektligji që po shqyrtojmë sot është një ogur i mirë se Kosova është në prag të realizimit të shtetësisë së saj, andaj është për t'u përshëndetur.

Me këtë Projektligji rregullohet përdorimi i simboleve shtetërore, si të flamurit, të himnit dhe të stemës, të cilat përfaqësojnë identitetin shtetëror të një vendi dhe të cilat domosdø duhet të rregullohen me ligj se si duhet të përdoren ato.

Duke pasur parasysh këtë, dhe se ky rregullim nuk është në kundërshtim me legjisacionin e Bashkësisë Evropiane, Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim Projektligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, duke punuar në komisione për të saktësuar dhe qartësuar nenet që rregullojnë këtë fushë të rëndësishme të një vendi, sepse flamuri, himni dhe stema janë simbole që do të përfaqësojnë në vazhdimësi shtetin e Kosovës.

Ajo që është për t'u përshëndetur në këtë Projektligji, është se qartësohet edhe përdorimi i simboleve kombëtare si e drejtë themelore e një populli për t'i përdorur ato. Andaj, ky Projektligji, merr mbështetjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet, edhe për shprehjen e shkurtër, lapidare.  
Fjalën e merr deputetja Gjylnaze Syla, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

**GJYLNAZE SYLA:** I nderuari zoti kryesues,  
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,  
Deputetë të nderuar,  
Kam kënaqësi të posaçme që në seancën e sotme plenare, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të trajtoj në parim Projektligjin për përdorimin e simboleve shtetërore.

Simbolet janë çështje me rëndësi nacionale, pjesë e identitetit tonë shtetëror. Prandaj, Projektligjit që e trajton këtë çështje, jemi të bindur se duhet dhënë prioritetin dhe konsideratën e merituar.

Grupi Parlamentar i Aleancës përshëndet iniciativën e Qeverisë së Kosovës për hartimin e tij.

Qëllimi i këtij Projektligji është që të reflektojë nevojën për përdorimin e simboleve të ndryshme nga ato që i kemi aktualisht në përdorim. Në esencë, Projektligji përfshin rregullat për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, të flamurit, të stemës dhe të himnit.

Gjithashtu, Projektligji në përgjithësi, praktikën e përdorimit të simboleve e vë në formën legjislative.

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah në parim Projektligjin për së paku pesë arsyë:

1. Kosova, ka nevojë për simbolet e veta dhe për caktimin e mënyrës së përdorimit për të demonstruar sovranitetin e vet të familjen e kombeve;

Prandaj, ky Projektligj është pjesë e rëndësishme e legjislacionit.

2. Kjo fushë, deri më tani, nuk është rregulluar me asnjë ligj, që e bën këtë ligj të domosdoshëm;
3. Projektligji është në pajtim me parimet dhe politikat e BE-së;
4. Dispozitat ligjore sigurojnë respektimin dinjitoz dhe përdorimin prominent të flamurit, të stemës dhe ekzekutimin apo intonimin e mirënjojur të himnit si nga institucionet qendrore dhe lokale, brenda dhe jashtë vendit, ashtu edhe nga individët.

Janë paraparë edhe mënyrat e përdorimit të flamurit shtetëror gjatë festave zyrtare dhe të flamujve kombëtar e të atyre dallues.

5. Çdo përdorim i simboleve, që shfaq mosrespekt, është paraparë të sanksionohet me gjoba prej 150 deri 1.000, gjë që eviton keqpërdorimet e mundshme.

Vërejtje të veçanta, përmendi edhe kolegia ime, zonja Kelmendi, që kanë të bëjnë më tepër me vetë heqjen e kllapave, por gjithashtu edhe përkufizimet që duhet bërë në ligj.

Edhe pse ligji nuk ka të bëjë me fizionominë, pra në përgjithësi me formën dhe përbajtjen e simboleve, në Ligj, në nenin 3 theksohet se ato përcaktohen nga Kuvendi i Kosovës, ashtu siç e theksoi edhe ministrja.

Sa i përket kostos së Projektligjit, e cila është llogaritur të jetë 70.000 euro, është e përballueshme për buxhetin e Kosovës dhe, natyrisht, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, gjatë procesit të buxhetimit, duhet ta marrë parasysh këtë shumë.

Sfidat, me të cilat mund të përballohet Ligji ndaj implementimit, janë se kostoja e zbatimit të tij mund të jetë më e madhe se shuma e vlerësuar.

Grupi Parlamentar i Aleancës do të kontribuojë më tej në përpunimin e këtij ligji. Miratimi sa më parë i këtij ligji, do të mbulojë zbratzësirën në këtë sferë të rëndësishme që përmbushë kërkesat e shoqërisë kosovare. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar ORA.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Grupi ynë Parlamentar mirëpret ardhjen e këtij ligji në Kuvend për shqyrtim të parë, sepse ky ligj plotëson kornizën ligjore dhe përgatitjen e gjithmbarshme të institucioneve dhe të çdo niveli për shtetin e ardhshëm të Kosovës. Kjo tregon edhe përkushtimin dhe angazhimin tonë që dita e definimit të shtetit të Kosovës të na pret e përgatitur në secilin aspekt.

Sidoqoftë, mendojmë se duhet të kihen parasysh edhe disa nene të cilat mund të shkaktojnë konfuzion apo mund të shkaktojnë një mosdefinim të qartë dhe ato janë: neni 4.2 dhe neni 7.2 të cilët mund paraqesin konfuzion, prandaj do të ishte mirë të kihet parasysh formulimi e fjalive në mënyrë më të saktë.

Gjithashtu, neni 13.2 ku definohet stema, të sqarohet neni 10.1 dhe 10.2.

Përndryshe, mendojmë se është një ligj i punuar mirë, një ligj i cili urojmë që së shpejti të përmbushet edhe me definimin e vetë simboleve, me të cilat, së bashku me Ligj për përdorim të simboleve do të krijojnë një tërësi të mirë.

Prandaj, si Grup Parlamentar, e përkrahim këtë ligj për të cilin do të kontribuojmë gjatë procesit të amendamentimit të tij në Komision. Faleminderit.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Sahatqija!

Fjalën e ka zoti Mahir Jagcilar, në emër të Grupit 6+.

**MAHIR JAGCILAR:** Faleminderit, zoti kryesues!

Sayın Meclis başkanı, sayın bakanlar ve milletvekilleri

Sembollerin doğrusu arma, bayrak ve milli marşın kullanımına ait Yasa, her ülkede özel önem taşıyanın bir unsurdur. Kurulmakta olan yeni bir ülke olarak biz, sözkonusu sembollerin saptarken bu sembollerin kullanım kurallarını da belirlememiz bir o kadar önemlidir. Öyleki grub olarak prensipte Yasa tasarısını kabul ediyoruz.

Diğer yandan Yasa önergesini dikkatla incelerken, yasanın bazı hükümlerinin, Başkan Ahtisarının Genel Kapsamlı Önergesi ile uyumlu olması gerektiğini, ulusal bayrakların kullanımıyla ilgili olan 6. maddenin daha ayan ve sembollerin kullanımı söz konusu iken

daha somut olarak belirlenmesi gerektiğini düşünüyoruz. Bundan başka Parlamento grubu olarak biz bu yasanın meclis prosedüründe katkı sunmaya hazır olduğumuzu da vurgulamak istiyoruz.

Dikkatinize teşekkürler. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Jagcilar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, fjalën e merr Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Inderuari kryesues,  
Të nderuar ministra,  
Deputetë të respektuar,  
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë përkrah vendimin e Qeverisë së Kosovës për sjelljen në Kuvend të Propozimligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës.

Se sa është i rëndësishëm ky Propozimligj, ndoshta edhe s'ka nevojë të debatohet, për të mos thënë se është paraqitur para ligjit më të arsyeshëm – Ligjt për simbolet e shtetit. Megjithëkëtë, nuk prish aq shumë punë.

Rregullimi i përdorimit të simboleve të Kosovës, siç janë flamuri, stema dhe himni, shënojnë edhe një hap përpara në shtetësinë e Kosovës, sepse, deri më tanj, përdorimi i tyre ishte i parregulluar dhe, në anën tjetër, flamuri, stema, himni paraqesin atribute të çdo shteti, në këtë kontekst edhe të shtetit të Kosovës.

Pjetja dhe dilemat më të mëdha, janë se cilat do të janë simbolet e shtetit të Kosovës, si duken ato, si tingëllon himni, e të tjera. Kjo do të thotë se nuk është problem përdorimi i simboleve shtetërore, por problem është pajtueshmëria e popullit me simbolet e veta shtetërore dhe kombëtare, në të cilat do të inkorporohen elementet e dëshiruara të kombit dhe shtetit. Si do të reflektohen këto në vullnetin politik të qytetarëve, sa do t'i promovojnë ato ata, sepse flamuri do të vendoset brenda objekteve dhe jashtë tyre, në festa e gjëzime, zyrtare dhe jozyrtare. Po ashtu, edhe stema do të përciljet në të gjitha aktet zyrtare të institucioneve të shtetësisë së Kosovës, në dokumentet dhe raportet reciproke ndërkombëtare.

Është shumë e natyrshme se Propozimligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, sikur që nuk do të duhej të ishte në kundërshtim edhe e drejta që simbolet e shtetit të Kosovës të paraqesin vullnetin e qytetarëve të saj.

Grupi Parlamentar i LDD, vlerëson se arsyeshmëria e normave juridike për përcaktimin e simboleve dhe radhitjen e tyre, duke kërkuar të caktohen rastet dhe mënyrat e përdorimit të tyre, në çdo rast, edhe të intonimit të himnit.

Propozimligji duhet të përcaktojë, shprehimisht, të gjitha rastet dhe vendet kur përdoret flamuri, stema dhe himni shtetëror në Kosovë, e jo të lejohet si mundësi: – shiko nenin 4 pikë 2, citoj: “Mund të vendoset, dhe në veçanti kur përdoret nga qytetarët, si dhe në rastet e përdorimit të flamurit kombëtar ose përdorimit vetëm flamurit kombëtar”.

Ne vlerësojmë se nuk duhet të kemi flamuj dallues në mes të institucioneve të Kosovës, por duhet të jenë shenjat dalluese në mes Qeverisë, ministrike e të tjera.

Vlerësojmë se, në një kuptim të veçantë, është dashur t'u kushtohet kujdes masave ndëshkimore në rastet kur nuk përdoren apo keqpërdoren simbolet e shtetësisë së Kosovës, kur dihet natyra e përbërjes heterogjene të popullatës së Kosovës.

Shikuar në tërsi, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, përkrah në parim shqyrtimin e parë, ndërsa vërejtjet tona do t'ia paraqesim komisionit funksional për ta begatuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kelmendi!  
Fjalën e merr Ferid Agani, në emër të Grupit Parlamentar për Integrin.

**FERID AGANI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar ministra të pranishëm,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Grupi Parlamentar për Integrin i bashkëngjitet shprehjes së mirëpritjes së këtij dokumenti të rëndësishëm ligjor në procesin e realizimit dhe të zbatimit të shtetësisë së Kosovës. E konsiderojmë si një dokument ligjor të punuar mirë dhe me kujdes.

Natyrisht, në tekstu ka edhe lëshime të natyrës teknike, por edhe përmbajtjesore, të cilat do të mund të korrigohen në procedurën e mëtutjeshme.

Në atë që kisha dashur të ndalëm, është neni 3.2, i cili përcakton se pjesë përbërëse e këtij ligji do të jenë edhe rregullat gjeometrike të pamjes së flamurit dhe të ngjyrave të tij, të stemës e të tekstit, si dhe të shënimit e notave të melodisë së himnit.

Mendoj se Projektligji është dashur në mënyrë më precize të përcaktojë mënyrën se si Kuvendi i Kosovës do të bëjë miratimin e përmbajtjes së simboleve shtetërore të Kosovës. Është lënë në mënyrë shumë të hapur dhe mendoj se pasi këto elemente do të jenë pjesë të këtij teksti ligjor, edhe ato duhet të kalojnë nëpër procedurë të njëjtë ligjore sikurse edhe teksti i Projektligjit, pra nëpër dëgjimin e parë dhe pastaj miratimi në dëgjim të dytë.

Një lëshim teknik, të cilin do ta theksoja dhe do të duhej të korrigohet patjetër, është në nenin 18, ku thuhet se Qeveria, sipas nevojës, nxjerr aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Mendoj se kjo nuk mund të qëndrojë. Pra, Qeveria është e obliguar që, në afat të caktuar kohor, t'i nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara me këtë Projektlig. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Agani!  
Fjalën e merr deputeti Emrush Xhemajli.

**EMRUSH XHEMAJLI:** Faleminderit, zoti kryesues i Kuvendit!  
Qeveritarë dhe kolegë deputet dhe të gjithë ju të pranishëm,  
Projektligji për simbolet shtetërore të Kosovës, për pikëpamjen e LPK-së, është një projektligj transitor.

Ne sot po procedojmë një Projektligj për simbolet shtetërore, simbole që ende nuk janë, dhe po anashkalojmë çështjen e përdorimit të simboleve kombëtare dhe të pakicave që janë në përdorim me shekuj. Në këtë kuptim, ne jemi Kuvendi më i çuditshëm, i cili vështirë se gjendet në gjithë botën.

Neni 6, me pikat përkatëse, mundohet të rregullojë edhe çështjet e përdorimit të flamurit kombëtar dhe të flamujve të pakicave, por është shumë larg nga ky synim, sepse lë të hapura shumë gjëra që vështirë mund të kalohen në procedurat dhe instancat e parapara me këtë ligj. Çështja e flamurit kombëtar shqiptar dhe të pakicave, nuk mund të mbetet kompetencë e akteve nënligjore, që do t'i nxirrte Qeveria.

Gjatë përdorimit të mëtejmë, mendojmë se duhet urgjentisht të bëhen dëgjime publike për këtë temë nga Komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës dhe të amendamentohet me përkushtim. Kjo do të evitonë ndarjen e shoqërisë sonë, edhe ashtu jo të bashkuar sa duam, me ata që i duan më tepër këto, sesa ato simbole. Secilit simbol duhet t'i vihet vendi i merituar dhe i nderuar. Kjo do të ishte zgjidhja.

Nëse këtë problematikë nuk e kuptojnë ata që nuk kanë jetuar gjatë në Kosovë, apo nuk janë thelluar në historinë e simboleve që janë përdorur deri më tash në Kosovë, mendoj se ky Kuvend e kupton këtë shumë mirë dhe, nëse gabon, gabimin e bën me qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Xhemajli!  
Fjalën e ka deputeti Agim Krasniqi.

(Ndërhyrje: Ndoshta janë ngatërruar kartelat!).

KRYESUESI: Agim, qëmoti e ke kërkuar fjalën, ke prekur atje diçka!  
Fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

(Ndërhyrje: Jo, unë e kam kërkuar fjalën, por i kemi ngatërruar kartelat! Kërkoi falje.)

KRKYESUESI: Ti, s'e ke kërkuar hiq. Numan Baliq e ka fjalën. Prit, më vonë e merr ti fjalën.

NUMAN BALIĆ: Pa dobro, možda je trebalo pustiti riječ ovoj gospodji, ali eto, ja ču govoriti, ako vi tako insistirate.

Najprije da selamim sve prisutne u sali i da kažem neka....

KRYESUESI: Veç një moment, Baliq.  
Tash dine se jeni paraqitur që të dytë, edhe Gjylsheni edhe Agimi. Të lutem, Baliq, urdhëro!

NUMAN BALIĆ: Faleminderit!  
Htio bih da iznesem neka osobna shvatanja vezano za zakon i neke konsekvenca koje su vezane sa usvajanjem zakona i budućnost ovog zakona.

Mislim da se svi slažemo u tome da imamo apsolutnu potrebu da oživotvorimo višedecenijska i višestoljetna zalaganja kosovskog naroda, imajući u vidu i većinski

Albanski narod, ali i druge narode koji žive i koji podržavaju te težnje za državnošću i stvaranje tih državnih simbola.

Na drugoj strani, imamo takodje jednu situaciju koja se tiče jedne potpune nejasnoće trenutnog stanja u kome se Kosovo nalazi i budućnosti statusa koji očekuje Kosovo.

Ako pitate mene, i mnoge ljudi na Kosovu, koji se bave ovim pitanjima, koje zanimaju i o kojima razmišljaju, status Kosova u stvari je trebao da se riješi možda još prije pet godina, a sa njima naravno i državni simboli, takodje.

Mi smo sada u prilici da donosimo zakon o državnim simbollima, a u opšte ne znamo kako će izgledati status Kosova. Dakle, mi ne znamo da li će Kosovo biti država, da li će biti neka krnja država ili neki drugi oblik državnosti, ili će možda doći do nekih nepredvidjenih tokova, kao što su produžavanja protektorata, produžavanja neriješenog stanja, zamrznuti status ili čak podjela Kosova. Nijedan od tih scenarija nije isključen.

U vezi sa tim, ponovio bih neke stavove koji se tiču stanja oko statusa Kosova, i to su sledeće:

Najprije, vrlo kratko. Ahtisarijev paket je, kao što već znamo, jako odugovlačen i već više mjeseci stoji na stolu i u ozbilnjkoj je krizi. Postoji čak mogućnost da bude i odbačen.

Najnovija dešavanja oko Kosova, koji se tiču pregovaračke trojke, jasno govore da prijedlog Ahtisarija nije osnovica u sadašnjim pregovorima. Dakle...

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

....Da, da, ima itekako veze! Itekako ima veze gospodjo ministarka, zato što mi radimo nešto čega može da se desi da je uzaludan trud, a to je moj posao kao i vaš posao. I ja mislim da ne možemo nijednom poslaniku zabraniti da govori ono što on misli. Govorimo o državnim simbolima i o statusu Kosova.

Dakle, ako gospoda Ischinger – Uizner i Hashcenko govore oko toga da Ahtisarijev paket nije više osnovica, a da mi govorimo o jednom zakonu koji direktno proističe iz tog paketa, onda je to itekako u vezi, gospodjo ministarka.

Prema tome, ako se takodje ima u vidu da nije isključen ni kompromis Beograda i Prištine, niti bilo koji scenarij, zamrznuti status, produženje ovakvoga stanja, produženje protektorata ili podijela Kosova – onda se postavlja ozbiljno pitanje – šta mi ovde radimo.

Mislim da, takodjer, trebamo voditi računa o još jednoj neuskladjenosti, a ona se tiče sledećeg:

Mi dobro znamo da je više decenija govoreno oko toga da zastava Kosova treba biti nacionalna zastava. Medjutim, sada smo u prilici da ovaj zakon u opšte ne definira izgled zastave. To je veoma jedan veliki problem. Može neko reći, i oni koji su podnosioci zakona, pa ovo je zakon o upotrebi državnih simbola i nije zakon koji govori o sadržaju zastave, himne, grbe i tako dalje, i tako dalje. Ali ja mislim da zakon prije svega mora definirati sadržaj, izgled zastave, izgled grba, himne i tako dalje. A ne oko toga, da li će

zastava biti desno ili lijevo, hoće li biti unutar, hoće li biti ispred, hoće li biti u holu, kako će biti poredjeno u odnosu sa drugim zahtavama, što – vjerujte mi meni, prilično liči na neke pravne neozbiljnosti. Donosimo zakon o zastavi, a ne znamo kako izgleda zastava. Raspisuje se konkurs, koji doslovce kaže da su zabranjena nacionalna obilježja. Zabranjena su nacionalna obilježja i većinskog naroda, i zabranjena su nacionalna obilježja i drugih zajednica.

Gospodin Džemajli je sa pravom upitao: ako donosimo zakon o zastavi, onda trebamo imati i zakon o manjinskim zastavama na Kosovu. Dakle, to su krupni nedostatci i ja sam prinudjen da reagujem na ovo.

Muslim da, uprkos potrebi sa kojim se potpuno svi slažemo da se treba donijeti zakon o zastavi i oko toga da se trebaju definirati i ova pitanja, ja mislim da moramo imati u obzir trenutnu situaciju koja postoji na Kosovu i da trebamo biti ozbiljni. To je ono što sam želio da vam poručim, da bi smo znali i da bi smo bili u skladu sa pozicijom na kojoj se nalazimo. Hvala vam lijepo!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!  
Fjalën e ka Gjulshen Berisha.

GJULSHEN BERISHA: Faleminderit!

Inderuari kryesues,  
Të nderuar deputetë, ministra,  
Më lejoni të shpreh kënaqësinë time që sot para nesh është për miratim Projektligji përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, përmes të cilave përfaqësohet Kosova dhe identiteti shtetëror i saj.

Përcaktimi i normave përdorimin e simboleve të Kosovës, përdorimi i flamurit, të stemës dhe të himnit, mënyra dhe radhitja e përdorimit të simboleve, përcaktimi i normave përvendosjen e flamurit, të stemës dhe përintonimin e himnit, janë çështje të adresuara që janë përcaktuar në nenet e Projektligjit në mënyrë shumë të mirë. Për këtë, ju përgëzoj.

Është me rëndësi që në këtë Ligj, Parlamenti i Kosovës, si organi më i lartë legjislativ i Kosovës, përcakton formën, përmasën e flamurit dhe të stemës, përbajtjen e tekstit dhe partiturën e himnit.

Prandaj, e përkrah në parim dhe veçoj nenin 3 të këtij Projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!  
Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha.

FETAH BERISHA: Inderuari zoti kryesues, ministra dhe ju që e përcillni këtë seancë,  
Të respektuar kolegë deputetë,  
Të gjitha projektligjet që i ka aprovuar ky Parlament, janë të rëndësishme për lëmitë që rregullojnë jetën tonë shtetërore. Por, Projektligji përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, të cilin po e shqyrtojmë sot në këtë seancë, vërtet është i një rëndësie të veçantë.

Çdo shtet i pavarur e ka identitetin e vet. Nuk ka shtet pa identitet. Edhe Kosova do të bëhet së shpejti shtet i pavarur, i cili duhet ta ketë identitetin e vet. Emrin dhe territorin Kosova e ka. Edhe simbolet – flamurin, himnin dhe stemën duhet t'i ketë, sepse simbolet janë shenjë e shenjtë e identitetit të shtetit të Kosovës.

Simbolet duhet të shprehin identitetin kombëtar dhe shtetëror të Kosovës. Mirëpo, çështja e simboleve shtetërore të Kosovës vazhdon të mbetet një çështje e nisur, por e papërfunduar. Qe shpallur edhe konkurs për simbolet, lexuan se kanë konkurruar rrëth një mijë dizajner. Konkursi paska paraparë edhe kriterin për ngjyrat e simboleve. Po ashtu, para ca viteve, Presidenti i ndjerë dr. Ibrahim Rugova, pati ideuar flamurin dhe himnin e shtetit të Kosovës, pra flamurin e Dardanisë dhe himnin “Kur ka ra kushtrimi në Kosovë” që janë shumë të fuqishëm edhe në pikëpamje kombëtare, edhe kanë domethënien tradicionale. Këto simbole disa vjet bënë një traditë dhe simbolizuan shtetin e Kosovës. Edhe sot, qytetarët e Kosovës, flamurin e Dardanisë e ruajnë me fanatizëm në shtëpitë e tyre.

Kjo çështje, çështja e simboleve, ka qenë e nevojshme të shtrohet njëherë edhe në Parlament, ngase në nenin 3 të këtij Projektligji, që po e shqyrtojmë sot, thuhet se forma dhe përbajtja e simboleve shtetërore të Kosovës, përkatesisht forma e flamurit dhe e stemës, përbajtja e tekstit të himnit, përcaktohen nga Kuvendi i Kosovës.

Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës është përpiluar me përkushtim nga ekspertë vendorë dhe është për çdo lëvdatë. Po ashtu, vlerësohet se në të ka edhe shpenzime shtesë dhe implikime të buxhetit, por këto janë të tejkalueshme. Mirëpo, me këtë projektligji do të rregullohet përdorimi, vendosja dhe radhitja e flamurit shtetëror të Kosovës, përdorimi i simboleve nga qytetarët, përdorimi i flamurit shtetëror në festa në raport me flamurin kombëtar dhe në raport me institucionet e ndryshme diplomatike që do t'i krijojë shteti i Kosovës.

Pra, me këtë Projektligj, përdorimi i simboleve shtetërore të Kosovës, flamuri, himni dhe stema, do të rregullohet me dispozita ligjore – fushë e cila ka qenë e parregulluar.

Meqë Kosova është në prag të pavarësimit nga Serbia, duhet të shpejtohet përzgjedha dhe përcaktimi i simboleve shtetërore, të bëhet aprovimi i të gjitha projektligjeve të cilat lidhen me pavarësinë e Kosovës.

Këtë Projektligj e përkrah dhe do ta votoj, në parim, sepse e meriton, ngase rregullon një çështje me rëndësi të veçantë, siç është identiteti shtetëror i Kosovës. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet!  
Fjalën e ka deputeti Xhevati Bislimi.

**XHEVAT BISLIMI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, për dallim prej kolegëve që folën, nuk do të thurë himne për këtë Projektligj. Uniteti, që po dëshmohet edhe kësaj radhe për një çështje kaq të madhe, si për disa çështje të tjera që i kemi pasur më parë, për mua ndjell frikë dhe pesimizëm, dhe në asnjë mënyrë optimizëm. Ky është një unitet shumë i rrejshëm, një unitet që nuk do t'i shërbejë Kosovës. Përkundrazi, ky projektligj dhe ky unitet i dëshmuar sot, janë vazhdimësi e përpjekjeve shekulllore që Kosovës t'i ndryshohet identiteti i saj kombëtar, historik, guhësor, kulturor. Dhe, nëse dikur perandor, car, sultani, kral, predsednik –

angazhoheshin për ndryshimin e identitetit kombëtar shqiptar të Kosovës – sot, dhe ka vite, që po angazhohen edhe disa qarqe brenda shqiptare, që Kosova të mos jetë shqiptare.

Angazhimi i popullit shqiptar, angazhimi i çdo shqiptari, i gjithë hapësirës shqiptare, ka qenë që Kosova të pavarësohet nga Serbia e jo Kosova të pavarësohet nga kombi i vet. Dhe, të jeni të bindur se do të dështon edhe ju, siç kanë dështuar kral, sultani e perandor në këtë tokë. Sepse, shqiptari është në këtë vend para zotit. Sepse simbolet e shqiptarit nuk ka zot që do t'i ndërrojë e jo ky Kuvend. Prandaj, mos u mashtroni nga ky unitet i rrejshëm, po ju garantoj. Sepse, populli shqiptar edhe kësaj radhe do ta sfidojë këtë unitet të politikave të rrejshëm që nuk përfaqësojnë interesat dhe vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës.

Ky ligj dhe ky Kuvend po e dhunon vullnetin e popullit shqiptar. Ky Kuvend nuk e ka të drejtën, absolutisht, që të vendosë dhe të diktojë flamurin për Kosovën. Kosova e ka flamurin e saj dhe ky është flamuri shqiptar. Krahas këtij flamuri mund të përdoren edhe flamuj të pakicave, të drejtat e të cilave as që i ka mohuar populli shqiptar, as nuk do t'i mohojë kurrë. Mirëpo, populli shqiptar nuk mund të heqë dorë nga identiteti i tij në favor të pakicave të tjera. Absolutisht! Sepse, nëse populli shqiptar nuk i ka të drejtat e tij, të jeni të bindur që s'kanë për t'i pasur as pakicat që jetojnë në Kosovë.

Problemi me Serbinë ka qenë pikërisht ky – identiteti shqiptar dhe flamuri shqiptar. Po të kishte hequr dorë populli shqiptar nga flamuri i tij, po të kishte hequr dorë nga identiteti i tij, po të kishte shpikur një gjuhë tjetër nga ajo shqipe, ndonjë gegërishte apo ndonjë lokalizëm tjetër, të jemi të bindur se me Serbinë do të jetonim shumë mirë. S'do të kishim asnjë problem, absolutisht.

Mija vjet burg janë mbajtur në Kosovë, në burgjet e Serbisë, pikërisht për flamurin shqiptar dhe jo për një flamur që do ta shpikë ndonjë mendje kozmopolite, siç e kanë shpikur këto ditë dhe siç u tregua një zell nga disa kozmopolitë që të bëjmë flamuj, bile nja një mijë a dy mijë, s'di sa i kanë propozuar.

Megjithatë, populli shqiptar ka të drejtën e tij historike kombëtare. Këtë të drejtë ia garantonjë edhe të gjitha dokumentet ndërkombëtare. Ju po vepron edhe kundër dokumenteve ndërkombëtare në fuqi. Nuk mund t'i ndërrrohet identiteti një populli, sepse kjo bie ndesh me të gjitha të drejtat e njeriut, me të gjitha dokumentet ndërkombëtare.

Nuk ka forcë që mund t'ia ndërrojë këtë identitet të cilin ia garantonjë të gjitha dokumentet ndërkombëtare.

Ka plotë shtete në botë...

**KRYESUESI:** Zoti deputet, nuk jeni në temë!

**XHEVAT BISLIMI:** .... ka shtete në botë që kanë të njëjtët flamuj. Ka shtete në botë që kanë flamuj të njëjtë, si Çadi, Rumunia, Luksemburgu e Holanda. Ka shtete që kanë flamuj me një ndryshim shumë të vogël. Pse nuk mund ta ketë Kosova flamurin e saj shqiptar edhe flamur shtetëror. Dhe, ne mund ta ndajmë identitetin tonë vetëm me Bashkimin Evropian. Në momentin që Kosova bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, mund ta ndajë identitetin e vet, mund ta vendosë edhe flamurin e Bashkimit Evropian. Mund ta

ndajë sovranitetin e vet dhe mund të heqë dorë nga shumë të drejta të saj në favor të Bashkimit Evropian, siç bëjnë popujt e tjerë, por në asnjë mënyrë nuk mund të heqim dorë nga flamuri ynë në favor të Serbisë, e në favor të serbive të tjera.

Prandaj, unë propozoj që ky ligj, të paktën, të shtyhet dhe për ndërrimin e flamurit, për një flamur të ri, të vendoset me referendum në Kosovë. Nuk mund të bëhet ndryshe kjo punë, sepse do të hapni një plagë të re, do të hapni një përcarje të re brendakombëtare, e cila nuk do t'i shërbejë Kosovës.

Ju po miratoni ligje nga plani i Ahtisarit, plan që nuk ka kaluar në Këshillin e Sigurimit.

Prandaj, në vend që ju të miratoni planin për pavarësimin e plotë të Kosovës nga Serbia, në vend që të mobilizoni institucionet, mobilizoni partitë, mobilizoni popullin shqiptar dhe pakicat që janë përkrah tij, t'i mobilizoni për pavarësi të plotë nga Serbia, ju po merreni me ligje, aq bajate në këtë kohë, aq të pa bereqet, aq shterpe sa nuk e keni idenë. Por, do të bindeni për këtë shumë shpejt. Ju faleminderit.

**KRYESUESI:** Fjalimin ta lejova, por fjalimi s'ka qenë i kësaj teme hiq. Ndoshta është koha që ke nevojë për t'i thënë këto sende, për sigurisht se do të vijë koha kur do të bisedohet për këtë temë.

E ka fjalën deputeti Fatmir Rexhepi.

**FATMIR REXHEPI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si deputet i këtij Parlamenti i gëzohem faktit që erdhi edhe momenti dhe dita që në këtë Parlament të debatohet dhe të procedohet Projektligji për simbolet shtetërore të vendit tonë që së shpejti pret njohjen e pavarësisë.

U bashkëngjitem vlerësimeve të atyre deputetëve për rëndësinë dhe punën e madhe që e pret Kuvendin në vazhdimësi për një dinamikë të re në ndërtimin e kornizës ligjore që ka të bëjë me shtetësinë e vendit tonë.

Në kuadër të Projektligjit do të veçoja tri pjesë të tij: E para është se ligji vërtet ka pak nene, më pak se 20, por nëse kemi parasysh peshën dhe rëndësinë politike dhe juridike që ka, atëherë ai është diçka i veçantë.

Nga dispozitat e përgjithshme dhe deri te dispozitat përfundimtare, trajton drejt me parime shumë të mira përdorimin e flamurit, të stemës, të himnit. Në një pjesë të veçantë, po ashtu, trajtohet flamuri kombëtar, përdorimi i tij dhe është shumë e arsyeshme që trajtohet në mënyrë të tillë.

Dhe, çështja e tretë, është ajo se në kuadër të Projektligjit Kuvendi është institucioni ai i cili do të vendosë për simbolet shtetërore e jo, siç na del neve shpeshherë, ndonjë komision i veçantë apo shoqatë mikste, të cilat nuk kanë as mandat, as imunitet politik të vendosin për çështje me rëndësi të veçantë.

Prandaj, në parim, përkrah këtë punë të mirë që ka bërë Ministria dhe Qeveria që sa më shpejt të procedohet dhe të aprovohet në Parlament. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputetë!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Koci.

**GANI KOçi: Faleminderit, zoti kryesues!**

Unë këtij Projektligji nuk do t'i thur as himne e ditirambe, por as elegji, jo. Mua më duket dhe e çmoj shumë zellin e institucioneve të Kosovës që të përmbush atë pjesën e pakos legislative që rrjedh nga Pakoja e Ahtisarit, por ky zell shpesh më ngjanë në atë lojën e vajzave të reja që bëhen nuse. Prandaj, një sërë ligjesh apo projektligjesh që i kemi këtu, nuk kanë preambulën dhe i kanë 4-5 iksa, që thonë se kjo mund të ndodhë në një të ardhme, nga një kushtetutë që, do të vijë a s'do të vijë, dhe nuk e dimë se kur do të vijë.

Unë mendoj se kjo nguti nuk na çon askund, absolutisht. Nuk e bën aq aktive ose nuk e tregon shumë aktive Qeverinë e Kosovës, duke pasur parasysh atë që e thanë shumë të tjera se vërtet ne nuk e dimë a do të jetë Pakoja e Ahtisarit bazë e shtetit të ardhshëm të Kosovës, a do të jetë një pako tjetër, dhe nëse është kështu, atëherë nuk e konsideroj si shumë të nevojshme këtë nguti të Qeverisë në këto projektligje.

Dihet mirëfilli se simbolet shtetërore, nga aspekti i së drejtës, hyjnë si kategori kushtetuese. Përcaktimi e forma, të gjitha, bëhen me kushtetutë. Nuk di, ata që po punojnë në këtë drejtim, a e kanë këtë parasysh dhe deri ku e në çfarë drejtimi kanë arritur.

Po ashtu, edhe përdorimi i simboleve kombëtare hyn në domenin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, që në këtë rast futen prapë si kategori kushtetuese. Prandaj, çmoj si shumë të padrejtë dhe shumë të pavend Qeverinë që futë nenin 6 në këtë Projektligji. Nëse futë nenin 6 në Projektligji, atëherë do të duhej të ndryshonte titulli “Ligji për përdorimin e simboleve shtetërore dhe kombëtare në Kosovë”.

Ne para veti kemi vetëm Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore, prandaj neni 6 nuk duhet të ketë vend këtu, sepse ne duhet të kemi një ligj tjetër që përcakton mënyrën e përdorimit të simboleve kombëtare: kur dhe në cilat raste duhet të përdoret simboli kombëtar krahas simbolit shtetëror, në cilat vende, duke pasur parasysh edhe këtë shumësi, që po quhet, të etniteteve në Kosovë.

Dhe, çështja tjetër. Kështu siç është thënë, lë mundësi tepër të madhe të abuzimit dhe të keqpërdorimit, ndoshta, me simbole kombëtare nga vetë qeveria. Nuk di çfarë qeverie do të jetë ajo, sepse në asnjë vend në botë, qeveria nuk përcakton me akte përdorimin e simboleve kombëtare, por përcakton me ligj dhe ligji duhet të nxirret nga ky Kuvend.

Çështja tjetër, që konsideroj se është e nevojshme të theksohet këtu, dhe diskutuesit e përmendën atë rrëth përbajtjes së flamurit ose të simboleve. Për përbajtje do të diskutohet dhe do të ketë vend të diskutohet. Por, një gjë duhet të përcaktohet qartë se kur dhe në cilat raste krahas përdorimit të flamurit shtetëror duhet të përdoren edhe flamujt, t'i quaj kushtimisht, flamujt kombëtarë.

Prandaj, do të duhej të hiqej neni 6 komplet dhe të mos të diskutojmë për gjëra që do t'i kemi temë diskutimi nesër.

Ne më vonë do ta kemi edhe ligjin të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të diplomaticë e tjera, e tjera që po ashtu tregojnë atë të parën se po duam të tregohemi të zellshëm ndaj Pakos së Ahtisarit dhe nuk e dimë a do të ketë fundi i procesit të statusit të Kosovës bazë Pakon e Ahtisarit.

**KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci!**

Fjalën e ka kërkuar Agim Krasniqi.

**AGIM KRASNIQI:** Faleminderit, zoti Kryesues!

Unë desha vetëm dy-tri vërejtje të shkurtra t'i theksoj, që konsideroj nuk janë edhe aq esenciale, por që do të hyjnë në përdorim gjatë procedimit të mëtutjeshëm në amendamentimin e Projektligjit. Mendoj se vlen konstatimi që Projektligji është hartuar mirë dhe ka bazë solide që të mund të shërbejë gjatë procedimit të mëtutjeshëm dhe më në fund ky Kuvend ta aprovojë një ligj çfarë është i duhur për përdorimin e simboleve shtetërore.

Unë u bashkëngjitem vërejtjeve që i dha zonja e nderuar Nekibe Kelmendi se në fillim të këtij Projektligji nuk janë cekur edhe përkufizimet e nocioneve që janë përdorur në këtë Projektligj.

Vërejtja e dytë, është se ka dublim të disa dispozitave, të disa paragrafëve. Për shembull, te “Vendosja e simboleve shtetërore”, ose të flamujve, më mirë të themi, “Ndalimi i vendosjes publike të flamujve, të cilët janë të vjetruar dhe të dëmtuar” përsëritet në dy vende, në dy dispozita, paragrafë, kështu që kjo do të korrigohet sigurisht.

Vërejtja e tretë, është gjithashtu dublimi i përdorimit dhe vendosja e flamujve gjatë festave zyrtare në Kosovë ose me rastin e festave zyrtare, kështu që do të duhej të jetë vetëm një fjali, të përfshihet me një paragraf apo në një pikë.

Dhe, vërejtja e fundit, është se sankzionet kundërvajtëse janë përfshirë në kreun e pestë, në nenin 17 si dispozita kalimtare. Mendoj se nuk e kanë vendin në kuadër të dispozitave kalimtare, por duhet të jetë në kreun e veçantë.

Këto ishin vërejtjet e mia dhe besoj se ky ligj nuk përfundon me aprovim në parim, por do të punohet edhe gjatë ditëve të ardhshme deri në aprovimin final dhe të gjithë deputetët do të kenë mundësinë që të begatojnë dhe të shtojnë dispozita e nene të tjera të këtij ligji. Mendoj se duhet përkrahur në parim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Krasniqi!

Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi.

**NAXHIJE DOÇI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Inderuari zoti zëvendëskryeministër,

Inderuari zoti ministër,

E nderuara zonja ministre,

Të nderuar kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishmit në këtë sallë, Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës është shumë i rëndësishëm dhe mase i domosdoshëm për Kosovën si shtet i ri në formim, ngase me të do të rregullohet ligjshmërisht përdorimi i simboleve shtetërore të Kosovës e që janë flamuri, stema dhe himni, me të cilat simbole edhe do të dëshmohet dhe përfaqësohet identiteti shtetëror i saj.

Me hartimin e këtij Projektligji, Ministria e Shërbimeve Publike ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë ngase deri më tani kjo fushë legislative tek ne ka qenë e parregulluar me dispozita legislative.

Me 5 kapituj të tij dhe me 19 nene të hartuara, Projektligji përfshin të gjitha normat për përdorimin e simboleve, siç janë: forma, përmasa, përbajtja, radhitja dhe kriteret e tjera të obligimit dhe të respektimit të përdorimit të simboleve.

Anëtarët e Grupit punues, kanë bërë një punë të pakrahasueshme. Në këtë Grup kanë marrë pjesë si anëtarë të Grupit edhe Partia Demokratike e Kosovës, Partia Reformiste ORA dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut.

Kujtoj se ndoshta do të ishte dashur që të marrin pjesë në këtë Grup punues edhe shkencëtarë eminent nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, nga Institut i Albanologjik e Institut i Historisë dhe nga Universiteti i Prishtinës në rolin e shkencëtarëve të dalluar, si etnologë, historianë, gjuhëtarë, e tjere.

Në fund, përkrah në parim këtë Projektligj dhe do të tha se është kënaqësi që shtetit të shumëpritur të Kosovës do t'i krijohen edhe simbolet e tij shtetërore. Është kënaqësi e madhe që sot kemi në procedim për miratim këtë Projektligj në Parlamentin e Kosovës, që është edhe institucion i vetëm që mund t'ia japë edhe formën finale të përdorimit të këtij Projektligji. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

I fundit e merr fjalën Kamer Kameri, i cili do ta përmbyllë shpresoj shkurt këtë shqyrtim.

**KAMER KAMERI:** Faleminderit!

Me siguri do të jam i shkurtër, sepse po përsëriten gjërat.

Vërejtja ime është te neni 6, për të cilin kishte edhe deputeti Koci. Po ashtu, edhe te neni 3 pika 3.2, për çka foli edhe deputeti Agani.

Kujtoj këtu nuk është përcaktuar apo nuk është qartësuar si duhet dhe i propozoj Komisionit funksional që ta përdorë këtë tekst:

“Rregullat gjeometrike të pamjes dhe të ngjyrave për formësimin e flamurit, të stemës, të tekstit të himnit dhe përcaktimit të notave të melodisë, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, pas konkursit paraprak, do të jenë pjesë përbërëse e këtij ligji”.

Unë mendoj se mund të mos kemi profesionist që t'i dimë notat e himnit, po të përcaktohet pas vendosjes së konkursit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Nëse zonja ministre ka të shtojë diç, le të urdhërojë.

Urdhëro Melihate!

Me këtë rast, thërras deputetët të bëhen gati për të votuar.

**MELIHATE TËRMKOLLI:** Ndoshta ka shumëcka për të svaruar. Unë kuptoj se mund të mos kemi ndoshta informacione për do çështje që janë shumë specifike edhe të ekspertëve, por për çështje që janë esenciale në punën tonë dhe që janë esenciale në kuptim të dallimeve të tyre, vërtet nuk po mbërrrij ta kuptoj mirë pse ndodh kjo.

Është bërë një ngatërrim në mes të asaj që quhet përcaktim i simboleve shtetërore dhe Ligjit për përdorimin e simboleve. Dhe, kujtoj që kjo çështje duhet të jetë shumë e qartë. Këtu, u pa se i bënë do ngatërresa do, pa qëllim, sigurisht, por thjeshtë janë ngatërruar.

Ligji për simbolet, ose çështja e përcaktimit të simboleve është një çështje tjetër. A kanë për t'u përcaktuar ato, si do të përcaktohen, cila do të jetë pamja, cila do të jetë forma – mënyra, unë besoj të gjithë deputetët e kanë të qartë procesin si ka shkuar deri tani e ndoshta edhe më tutje si do të shkojë.

Me këtë Ligj përcaktohen irregullat e përdorimit të atyre simboleve që do të definohen. Do të thotë, nuk definon ky simbolet, nuk përcakton cilat janë ato, por mënyrën e përdorimit.

Te Pakoja e Presidentit Ahtisari, absolutisht, në asnjë mënyrë, kjo nuk i referohet në kuptimin e substancës së Projektligjit sipas Pakos së Presidentit Ahtisari. I referohet vetëm në kuptimin e asaj që ka nevojë të bëhet si ligj. Përndryshe, këto rregulla përdoren çdokund në botë. Domethënë, çdo shtet, i cili funksionon si shtet i pavarur, i përdorë irregullat e tillë të përdorimit të simboleve.

Prandaj, në këtë kuptim unë kisha për të thënë, thjeshtë, që nuk ka të bëjë kjo as me ekspertë, as me Institutin Albanologjik, e tjera. Janë irregullat që përdoren në praktikat e shumicës së vendeve që i kanë simbolet dhe identitetin e vet shtetëror.

Dhe, kujtoj, Projektligji është i mirë dhe duhet të miratohet.

Unë nuk do të hyj edhe në do detaje të tjera. Dikush e ka thënë këtu, që edhe gegërishtja nuk është shqip. Sinqerisht, nuk e kam të qartë çka ka dashur të thotë me këtë, por s'kisha dashur të hyjë më tej lidhur me këtë. Faleminderit shumë!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja ministre!

Ju ftoj, zotëri deputetë, të bëhem i gati për votim.

Sipas shënimive të mia që kam këtu, në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Votojmë tash për Ligjin.

Me 68 vota “për” dhe 1 “kundër”, miratohet Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës në leximin e parë.

Pas miratimit në parim, në bazë të irregullave 23 dhe 35, Kuvendi, ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues;
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese;
- Komisionin për Buxhet e Financa; dhe
- Komisionin për Komunitete.

Ju njoftoj se pika e katërt e rendit të ditës shtyhet për pak më vonë, meqë referuesi, në kohën e duhur nuk ka pasur mundësi të jetë në Kuvend.

Ndërsa, për pikën e pestë, më duhet ta informoj zëvendësministrin se nuk ka mundësi të procedohet në Kuvend pa qenë prezent ministri, për shkak se ekziston vendim i këtij Kuvendi që të mos bëhet kjo nga zëvendësministrat dhe unë duhet ta respektoj atë vendim.

Domethënë, pika është në rend dite dhe nëse arrin ministri ta paraqesë Ligjin, ne do të procedojmë. Ky është vendim i këtij Kuvendi.

Shkojmë më tutje. Në radhë është pika e gjashtë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shtator 2007 dhe janë përm bushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ligjin do ta paraqesë para deputetëve zëvendëkryeministri, Lutfi Haziri. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Jam i nderuar që para këtij organi të respektuar të paraqes, në emër të Qeverisë, Projektligjin për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Kosovës, i cili përkufizon kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Kjo bëhet me qëllim të rregullimit me ligj të autoritetave dhe të kompetencave të institucioneve të Kosovës në ushtrimin e marrëdhënieve me shtetet dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të interesit politik dhe ekonomik të Kosovës në aspektin ndërkombëtar, të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të Kosovës jashtë vendit, si dhe të zhvillimit të raporteve politike me shtetet e tjera.

Përmes këtij ligji, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Shërbimi Diplomatik, forcon edhe më tepër rolin dhe angazhimin e institucioneve të Kosovës.

Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme ka formën dhe strukturën standarde që përdoret për legjisacionin kosovar.

Ky Projektligj nuk është konform Kornizës kushtetuese të Kosovës, por është në përputhje me angazhimet tona dhe lidhet ngushtë me propozimin gjithëpërfshirës për statusin final të Kosovës, që del nga dokumenti i zotit Ahtisari, si ndërmjetësues ndërkombëtar.

Miratimi i këtij Projektligji në leximin e parë, mundëson që Kuvendi i Kosovës të njihet më për së afërm me fushëveprimin, përkufizimet, kompetencat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës.

Projektligji definon Shërbimin Diplomatik të Kosovës, që paraqet tërësinë e anëtarëve të përhershëm të Ministrisë së Jashtme, si dhe anëtarët e ministrisë së caktuar në misionet diplomatike jashtë vendit, misionet diplomatike që nënkuftojnë ambasadat ose zyrat e tjera që përfaqësojnë Kosovën në një shtet tjeter apo organizatat ndërqeveritare, të cilat janë në përputhje të plotë me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëni diplomatike të vitit 1961 dhe Konventën e Vjenës mbi marrëdhëni konsullore të vitit 1963.

Ky Projektligji, gjithashtu, përcakton mënyrën dhe kriteret e përzgjedhjes së shefit të misionit, domethënë të ambasadorit ose të ndonjë personi tjetër të autorizuar nga institucionet kompetente të Kosovës për të ushtruar detyrën në mision.

Neni 3 i Projektligjit paraqet shtyllën kryesore të punës dhe të misionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës, që përndryshe, të dy këto janë pjesë e punës së Qeverisë së Kosovës.

Shtyllat kryesore, që ky Projektligj synon ta arrijë, janë:

- a) Zhvillimi dhe bashkëpunimi i politikave të Qeverisë së Kosovës dhe të Presidencës ndaj shteteve të tjera, dhe në të njëjtën kohë shpreh dhe mbron interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
- b) Përfaqësimi i Kosovës dhe i institucioneve të saja shtetërore në vendet e Jashtme - dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare, përmes ambasadave, misioneve ose zyrave përfaqësuese të cilat i cakton Ministria në konsultim me Presidentin e Kosovës dhe në përputhje me programin e Qeverisë dhe me orientimet e Kuvendit;
- c) Veprimi në vende të tjera dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare në emër të ministritive dhe të organeve të tjera shtetërore.

Aktivitetet e tilla, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në promovimin e tregtisë dhe të investimeve të huaja në Kosovë dhe lëshimin e pasaportave ose të dokumenteve të udhëtimit për qytetarët tanë që jetojnë jashtë Kosovës.

Çdo funksion ekzekutiv, i kryer në cilësinë e Ministrisë, si bartës i organeve të tjera, rregullohet me akte nënligjore dhe në marrëveshje të nivelit të Shërbimit, të dakorduara nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe ministritë ose organet shtetërore përkatëse.

Kjo ka të bëjë, më së shumti, me zyrtarët e tjerë të institucioneve të Kosovës, që do të vendosen në ambasada apo në zyre të Ministrisë së Jashtme, si për shembull – zyrtarët e Agjensionit të Integrimeve Evropiane, që do të punojnë në Bruksel.

- d) Ofrimi i ndihmës konsullore qytetarëve të Kosovës në vendet e tjera, si dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe të tjerë kosovarë me banim të përkohshëm në vend ose të përhershëm në vendet e tjera, që është njëra nga kërkesat kryesore të viteve të pasluftës;  
Bashkërendimi ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe misioneve diplomatike, ose përfaqësuesve të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare në Kosovë;
- f) Ruajtja dhe mbrojtja e imuniteteve dhe e privilegjeve në Kosovë të misioneve dhe të personave, të cilëve iu takon imuniteti dhe privilegi sipas konventave dhe zakoneve ndërkombëtare.  
Ministria do të marrë masa të duhura përbreda të së drejtës ndërkombëtare, të njohur përgjithësisht që të rregullojë dhe parandalojë keqpërdorimin e statusit diplomatik, të imuniteteve dhe të privilegjeve.
- g) Bashkërendimi dhe konsultimi me Kryeministrin, Komisionin Parlamentar për Marrëdhënie me Jashtë dhe Presidentin lidhur me drejtimin strategjik të çështjeve të politikës së jashtme të Kosovës;
- h) Lidhja e traktateve dhe e marrëveshjeve të tjera obligative ndërkombëtare me shtete të tjera dhe me organizata ndërkombëtare ndërqeveritare.

Ky ligj, gjithashtu, përcakton kompetencat për lidhjen e marrëveshjeve dhe të traktateve.

Sipas ligjit, ministri i Punëve të Jashtme, Presidenti dhe Kryeministri kanë autoritet për të nënshkruar traktate dhe konventa obligative ndërkombëtare në emër të Kosovës.

Sipas nenit 4.1 ministri mund të delegojë me shkrim këtë autoritet te krerët e ambasadave apo të misioneve diplomatike të Kosovës jashtë dhe të ministrive apo të autoriteteve të tjera.

Traktatet dhe konventat e tillë, nuk hyjnë në fuqi deri sa nuk ratifikohen nga Parlamenti i Kosovës.

Sipas Projektligjit, Presidenti i Kosovës, pasi të pranojë propozimin me shkrim nga Kryeministri i Kosovës, do të vendosë për hapjen e ambasadave apo të misioneve të tjera diplomatike jashtë Kosovës. Këto misione do të janë nën autoritetin dhe udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Konsullatat, në vendet ku Kosova ka ambasadorë dhe ambasada të akredituara, janë nën autoritetin ose udhëzimin e atij ambasadori dhe konsiderohen zyra vartëse nën këtë mision.

Nenet 6 dhe 7 të këtij Projektligji parashohin kriteret e përzgjedhjes së ambasadorëve, të konsujve dhe të shefave të misioneve, si dhe mënyrën e emërimit të tyre.

Sipas nenit 7.2 ministri i Jashtëm, pas konsultimit me Kryeministrin dhe Presidentin e Kosovës, i dërgon një listë të ngushtë prej së paku 3 kandidatëve për secilin post vakant në besim Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Parlamentit të Kosovës.

Komisioni mban seancë të mbyllur dëgjimore për këta kandidatë për të vërtetuar se a i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 6 të këtij Ligji. Pas kësaj, iu raporton rezultatet e dëgjimeve të tij në besim Presidentit, Kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme.

Raporti i Komisionit nuk bën rekomandime lidhur me kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret nga neni 6 i këtij Ligji, por kontrollon, mbikëqyr dhe rekomandon në pjesën kryesore të autoritetit për të plotësuar këto vende të rëndësishme në misione jashtë Kosovës.

Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm, vendos pastaj nëse njëri nga kandidatët duhet të emërohet për në shtetin pranues ose organizatën ndërqeveritare ndërkombëtare.

Pasi të jetë marrë pëlqimi nga shteti pranues, Presidenti akrediton kandidatin më të suksesshëm.

Shteti pranues, në këtë proces, ka rëndësi të veçantë, sepse pëlqimi apo pranimi i kandidatit nga ana e shtetit pranues është kryesor.

Prandaj, edhe kemi propozuar që dëgjimet të bëhen në seanca të mbyllura. E tërë kjo është në përputhje me praktikat zakonore diplomatike.

Emërimi i personelit tjeter, në ambasada ose misione jashtë, bëhet në përputhje me legjislacionin i cili irregullon shërbimin civil dhe aktet nënligjore të Ministrisë.

Anëtarë të Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të të nominuarve politikë, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës.

Neni 7.4 parashevë që, së paku 50% të emërimeve të reja të shefave të misioneve nga data e caktuar, pesë vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të bëhen anëtarë në detyrë të Shërbimit Diplomatik të Kosovës, që do të mundësojë krijimin e një strukture të qëndrueshme për shërbim diplomatik për shtetin e Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme do të nxjerrë edhe akte të tjera nënligjore të domosdoshme sipas këtij ligji, si dhe akte të tjera nënligjore me qëllim të mbarëvajtjes më të mirë të Ministrisë.

Duhet të dihet se ky Projektligj nuk mund të kalojë në procedurat finale në Kuvendin e Kosovës shkaku i kompetencave që për momentin janë të rezervuara nga UNMIK-u, por kalon procedura të nevojshme në Kuvend për dëgjimin e parë, në mënyrë që në ditën e parë të pavarësisë të jetë i gatshëm për aprovim dhe të lehtësojë themelimin sa më të shpejtë të Ministrisë së Jashtme.

Kosova ka nevojë për Ministrinë e Jashtme dhe deri tani Qeveria e Kosovës ka punuar dhe identifikuar strategjinë, sfidat dhe aktivitetet e tjera për themelimin dhe funksionalizimin e kësaj Ministrie.

Kjo Ministri do të krijojë imazhin e mirëfilltë të Kosovës, do të ndihmojë në aderimin në organizatat kryesore ndërkombëtare, do të lehtësojë investimet e huaja dhe mbi të gjitha do të përfaqësojë interesat e popullit të Kosovës jashtë vendit tonë.

Faleminderit shumë!

#### KRYESUESI SABRI HAMITI:

Më lejoni që edhe unë t'i them dy-tri fjalë në emër të Komisionit.

Kolegë të nderuar,

Zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Unë do ta përkrah këtë Projektligj në emër të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike.

Do t'i them dy-tri fjalë, meqë po më duket s'ka nevojë ta zgjas më shumë, sepse zëvendëskryeministri ishte shumë praktik dhe edukues dhe e lexoi gati të gjithë Ligjin, kështu që, besoj, e keni të qartë.

Rëndësinë e këtij Projektligji e shoh, se:

1. Rregullon autoritetin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës lidhur me punët e jashtme dhe mbështet interesat politike dhe ekonomike të Kosovës;
2. Rregullon themelimin e Ministrisë së Punës të Jashtme dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës duke i përfshirë edhe marrëdhëni kalimtare, dhe
3. Krijon kuadrin ligjor që në nivel institucional të merren kompetencat në punë të jashtme nga institucionet e Kosovës.

Në Ligj, unë shoh një strukturim të përshtatshëm të institucioneve të Kosovës që preken ose janë përcaktues apo faktor në krijimin e politikës së jashtme, një balancim që, unë e quaj të mirë, në mes të Ministrisë, të Qeverisë, të Presidentit dhe të Parlamentit. Besoj se ky balancim dhe harmonizim do të prodhojë, më në fund, edhe një përfaqësim diplomatik që quhet profesional dhe përtej politik.

Komisioni ynë e mirëpret dhe mendon se është një nga ligjet fundamentale, që do të ligjësojë kompletimin e resorëve në Qeverinë e Kosovës, një nga resorët më të rëndësishëm në marrjen e kompetencave në punë të jashtme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** E ka fjalën deputeti Alush Gashi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**ALUSH GASHI:** Faleminderit, zoti kryesues, Sabri Hamiti!

Duke i dhënë mbështetje të plotë këtij Projektligji, falënderojmë ekselencën e tij, zotin zëvendëskryeministër, për prezantimin ekstensiv të këtij Projektligji.

Fatmirësish, kemi ardhur në fazë të zhvillimeve demokratike, të qëndrueshmërisë institucionale të vendit tonë, që na mundësohet që jashtë vendit tonë ne të flasim për vendin tonë, që ne t'i mbrojmë interesat e vendit tonë.

Një prej padrejtësive më të mëdha, që i është bërë këtij vendi qe tetë vite, ka qenë dhe ende është pamundësia që ne ta përfaqësojmë interesin e vendit tonë dhe përfaqësuesit tanë të mos jenë në radhë të dytë të përfaqësimit të interesave, por të jenë në radhë të parë.

I gjithë procesi i bashkëbisedimit për status me bashkësinë ndërkombëtare ka krijuar mjaft vështirësi për mungesë të këtij ligji dhe për mungesë të mirëkuptimit nga bashkësia ndërkombëtare që ne t'i zhvillojmë, së bashku me ta, marrëdhëniet e jashtme.

Edhe në pjesën e Kornizës kushtetuese, ku i mundësohet dhe i lejohet Kryetarit të Kosovës, si simbol i imunititetit, ta kryejë këtë punë, vitet kanë treguar se kjo ka qenë shumë e vështirë dhe shpesh e anashkaluar, nëse jo plotësisht, edhe e pamundësuar.

Si Grup Parlamentar, mbështesim vlerësimin e Komisionit funksional lidhur me këtë Projektligj, i cili, për nga strukturimi, është një prej skemave më të rëndomta të ministritive të punëve të jashtme të vendeve sovrane dhe mendoj se do t'i plotësojë nevojat e vendit tonë. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Gashi!

Fjalën e merr deputeti Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

**RAMË BUJA:** I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Çështja e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës nuk ka mundësi që të mos pëershëndetet edhe nga Grupi ynë.

Mirëpo, unë dua të nisem nga diçka që ndoshta për herë të fundit do ta them, sepse janë bërë shumë vërejtje të kësaj natyre, por diçka që është jashtë ligjit dhe janë do shkresa përcjellëse e shoqëruese që, në bazë të nivelit që kanë, janë shkresurina dhe të vjen keq

pse e shoqërojnë Ligjin. Sinqerisht të them, ndoshta ka ndonjë fjali që s'e kam marrë vesh dhe dua t'ju lexoj diçka, jo për t'ju irrituar, por për të thënë diçka.

Për shembull, kur është çështja e shkresës shoqëruese për koston buxhetore, thotë, mes tjerash, një fjali: "Vlerësimi i ndikimit buxhetor është i bazuar në supozime". S'e kam idenë, çka nënkupton kjo. Domethënë, ishte irrituese, përveç pjesëve të tjera.

Pjesa tjetër që është, po kështu, e jashtëligjshme e kësaj shkrese këtu është se hala sikur nuk ka mund të harret ajo punë, të hiqet "implikimi buxhetor i vitit 2007". Dihet ky ligj se çfarë implikimi do të ketë dhe kur dhe sikur nuk ka mund të hiqet ajo fjali që e ka shoqëruar këtë Ligj. Pra, e lëmë këtë punë, t'i hymë punës së Ligjit.

Është Ligj shumë i nevojshëm, shumë i domosdoshëm dhe jam ithtar i asaj që të mos i mbështes kolegët e mi dhe le të më falin – se cilës pako do t'i përkas ky Ligj – të Ahtisarit apo pakove çfarëdoqoftë, ky ligj i duhet Kosovës së nesërme, shtetit të ri të Kosovës dhe është mirë që është bërë.

Dhe, vërejtja kryesore është se, kur po i përkthejmë këto ligje, sepse dihet nuk zbulojmë rrotën as makinën e avullit me to, ligjet dihet si bëhen. Megjithatë, për hir të korrektësisë dhe respektit për institucionet tona, do të duhej që ta përshtatim më mirë. Ta përshtatim më mirë dhe të bëjmë punë më serioze rrëth kësaj gjëje.

Për shembull, në pikën 7, vërtetë në nenin 7 pika 7.2 flitet për Komisionin për Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Nuk din sponsoruesi ose hartuesi i Ligjit se ne nuk e kemi atë Komision me këtë emërtim, por duhet të jetë emërtimi adekuat çfarë e kemi, kështu që do të duhej për këtë të kihet kujdes.

Përveç kësaj, thuhet, mes tjerash, e që unë s'kam dëgjuar që ndonjë ligj i botës të jetë i shkruar dhe i sankzionuar, që shërbimin civil, vërtet diplomatët të zgjidhen me logjikën e shërbimit civil ose me konkurse, e tjera e tjera, që ai duhet të korrigohet sepse është diçka që është një defekt jo i vogël. Është defekt shumë i madh.

Pastaj, përdoret në iks-raste termi "qytetari i Kosovës si shtetas". Pse ka nevojë "qytetari i Kosovës si shtetas"? Shtetas i Kosovës, është diçka shumë normale që të përdoret dhe, besoj, logjike e përbajtjesore.

Ka edhe çështje të tjera, që do të mund tëjenë të nevojës për të debatuar këtu, mirëpo ne si Grup Parlamentar do të jepim kontributin dhe do ta përplotësojmë këtë në Komision.

Edhe një çështje do ta kisha thënë. Ka vende të demokracisë së konsoliduar që, ligjet e kësaj natyre, me këtë emërtim kaq të madh, nuk i bëjnë dhe e kanë ligj të veçantë ligjin për ministrinë e punëve të brendshme ku futet edhe puna e diplomacisë si sfond i veçantë dhe sqarohet në këtë ligj. Ne tash e kemi emërtuar kaq gjatë dhe mbështetje e kemi ngarkuar: Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme, është e ditur se ka për barrë, për bazë dhe për obligim që ta fusë në këtë sfond edhe këtë fushë.

Ne, si Grup Parlamentar do ta përkrahim në parim për të punuar pastaj në punën e mëtutjeshme në komisionin e caktuar parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, kolegut Ramë Buja!  
Gjylnaze Syla, shefe e Grupit Parlamentar të AAK do t'i paraqesë pikëpamjet.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!  
Inderuari zoti kryesues,  
Inderuari zoti zëvendëskryeministër,  
Të nderuar deputetë,

Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës është i rëndësishëm për interesin nacional të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Aleancës, përgëzon Qeverinë për hartimin e tij. Nevoja për këtë Projektligj është urgjente, marrë parasysh se nuk ekziston ligj për këtë fushë, prandaj është një nga ligjet prioritare.

Aktualisht, në Kosovë, jemi edhe dëshmitarë të asaj se mungesa e një mekanizmi të tillë ka shkaktuar edhe mungesën e prezencës tonë më të madhe ndërkombëtare dhe të ofrimit e të lobizimit të çështjes së statusit të Kosovës.

Me këtë Ligj, themelohet një institucion i ri – Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe Shërbimi Diplomatik i Kosovës, si pjesë e Qeverisë së Kosovës.

Përbajtja e Ligjit ka të bëjë me përgjegjësitë dhe organizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Qëllimi i Ligjit, tanimë kryetari i Komisionit e theksoi, se është autoriteti dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës për punët e jashtme, për mbrojtjen e interesave, por edhe promovimin e interesave politike, ekonomike dhe krijimin e marrëdhënieve me shtetet e tjera.

Gjithashtu, fushëveprimi i këtij Projektligji përfshin mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës jashtë shtetit.

Aspektet e përgjithshme të këtij ligji. Meqenëse është Ministri e re, duhet ndërtuar nga fillimi, prandaj edhe kostoja e kësaj Ministrie do të varet nga vendimet politike për numrin dhe strukturën e misioneve diplomatike jashtë Kosovës dhe të të punësuarve në Kosovë dhe jashtë saj.

Për këtë arsy, konsiderojmë se zgjidhja e ofruar për zbatimin e Projektligjit është e bazuar në supozimin e punësimit të 62 punëtorëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe 84 punëtorë në 14 misione diplomatike jashtë Kosovës.

Në bazë të kësaj, është bërë vlerësimi i shpenzimeve për katër vite – 2007-2010, që është pak mbi 36 milion euro me rritje të buxhetit për çdo vit pasues.

Grupi Parlamentar i Aleancës, konsideron se zgjidhja e ofruar për çështje të përmendura, është e arsyeshme dhe praktike ngase u përgjigjet nevojave të Kosovës. Në një periudhë të tillë, kur Kosova ka një buxhet të limituar, nuk mund t'i lejojë vetës një numër të madh të përfaqësive jashtë vendit, por në vitet e mëpasme, kur buxheti i Kosovës do të rritet – kjo gjë do të jetë e mundshme.

Përveç kësaj, konsiderojmë se me zgjidhjet e ofruara nuk do të kenë nevojë për ndryshime të këtij ligji për vite të tëra.

Ndikimet për rritjen buxhetore janë të vazhdueshme, prandaj Ministria e Ekonomisë dhe e Financave duhet të ketë një vëmendje të posaçme në kontrollin e tendencës së mundshme për më shumë shpenzime sës që është e arsyeshme, por edhe duhet të planifikojë edhe shpenzime të mundshme shtesë gjatë procesit të planifikimit buxhetor.

Po ashtu, Kuvendi i Kosovës duhet të ushtrojë kontroll të fuqishëm në mbikëqyrjen e buxhetit të kësaj Ministrie. Në Ligj kjo është e rregulluar me përgjegjësinë që ka Ministria për të raportuar para Kuvendit një herë në vit lidhur me objektivat dhe aktivitetet e Ministrisë për vitin paraprak.

Projektligi është në përputhje me propozimet gjithëpërfshirëse të statusit final. Po ashtu është në përputhje edhe me standarde ndërkombëtare.

Kompetencat e Ministrisë janë standarde ashtu sikur edhe të institucioneve tjera të Kosovës, e po ashtu edhe aktivitetet e ministrit, kurse ato diplomatike bazohen në konventat ndërkombëtare përmarrëdhënie diplomatike.

Ambasadat përfaqësojnë shtetin në tërsi, prandaj përfaqësojnë edhe ministritë e tjera. Përzgjedhja e ambasadorëve nuk është tërësisht në duart e ministrit të Punëve të Jashtme. Ambasadorët duhet t'i dërgojnë raportet, pos ministrit të Punëve të Jashtme, edhe Kryeministrit dhe Presidentit. Kjo është një qasje e unifikuar në zinxhirin e përgjegjësive. Raportet e veprimit në mes të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ministritë tjera, janë paraparë përmes marrëveshjes së nivelit të shërbimit apo të marrëveshjes së mirëkuptimit.

Traktatet dhe konventat ndërkombëtare mund të nënshkruhen nga ministri i Punëve të Jashtme, Kryeministri ose Presidenti, por traktatet dhe konventat obligative ndërkombëtare duhet të ratifikohen nga Kuvendi i Kosovës.

Aspekte të veçanta të këtij Projektligji janë se duhet të nxirren akte nënligjore përrugimin e plotë dhe organizimin e Ministrisë, dhe e dyta – duhet të ketë plan gjithëpërfshirës afatgjatë përrugim, i cili nuk duhet të ketë implikime buxhetore.

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah në parim. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e merr shefe e Grupit Parlamentar të ORA-s, Teuta Sahatqija.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, zoti kryesues!

Po e shoh se Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës tashmë nisi të sjellë atë fryshtë e diplomacisë. Prandaj, i nderuar i zëvendëskryeministër, ekselenca juaj dhe të nderuar deputetë,

Më lejoni që edhe unë të them diçka për këtë Ligj. Ky Ligj është njëri prej ligjeve në vargun e ligjeve të cilat dalin prej Pakos së Ahtisarit dhe Pakoja e Ahtisarit, në fakt është prej 5 prillit, kur ky Kuvend e ka miratuar dhe është shndërruar në pakon tonë, në legjislacionin tonë, në strategjinë tonë. Prandaj, nuk kemi pse të çuditemi që ky Ligj – Ligji paraprak të cilin e shqyrtuan dhe ligjet të cilët do të vijnë, janë ligje të cilat ne në fakt i kemi miratuar përmes miratimit të “Pakos së Ahtisarit”. Me këtë vazhdohet të tregohet përkushtimi i institucioneve tona për përgatitje përfshirës së statusit.

Në qoftë se i referohemi mbledhjes së fundit për statusin, atëherë shihet se edhe Ekipi Negociator, edhe të gjithë ne, nuk kemi mandat tjetër përpos të pranimit të statusit të pavarësisë së Kosovës, gjë të cilën e ka mandatar ky Kuvend.

Gjithashtu, në këtë Ligj, të cilin ne e pranojmë si Ligj që ka arritur në Kuvend, kemi edhe disa vërejtje.

Sa u përket konsullatave, kjo çështje nuk është definuar aq sa duhet dhe vetëm ndihma konsullore përshkruhet në nenin 3.2 dhe mendojmë se për këtë çështje duhet të ketë shpjegim dhe trajtim pakëz më të veçantë.

Gjithashtu, neni 6, në të cilin flitet për kritere, është një nen bukur sipërfaqësor dhe i përgjithësuar dhe ky nen do të duhej të specifikohet në mënyrë pak më të thuktë dhe më të detajuar.

Neni 7, i cili përcakton emërimin e shefave të misioneve, përkatësisht nenet 7.2, 7.3 dhe 7.4 janë nene të cilat kanë të bëjnë me përzgjedhjen dhe nuk kanë qartësinë e duhur dhe, esencialisht, këto nene pamundësojnë opozitën që të ketë mundësi të propozimeve apo të çfarëdo ndikimi.

Sidomos neni 7.2, në të cilin fjala “në besim” përsëritet disa herë, është nen, në të cilin Kuvendi anashkalohet, kompetencat i jepen Komisionit dhe Presidentit, dhe në këtë nen transparenca është diçka e cila nuk ekziston.

Neni 7.3 flet për akreditimin, në të cilin përsëri roli i Kuvendit nuk ekziston, përvèç kur trajtohet buxheti.

Prandaj, mendojmë që ky nen do të ketë nevojë të trajtohet në komision dhe kur të flasim për komision, do të duhej të ishte mirë që të kemi mbledhje në komision dhe të flasim për ligje në emër të komisionit, e po në këtë komision ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!  
Fjalën e merr Mahir Jagcilar, në emër të Grupit 6+.

**MAHIR JAGCILAR:** Po, edhe një herë ju falënderoj, zoti kryesues.

Sayın Başkan, saygınlı bakanlar ve milletvekilleri,  
Her ülkenin normal işlevliliği için, dışişleri bakanlığının ve diplomatik hizmet ile kadroların var olması son derece önemlidir. Dolayısıyla bulunduğumuz durumda biz, Dışişleri Bakanlığı ve diplomatik hizmetlerine ait belli bir Yasaya sahip olmalıyız. Bu anlamda sözkonusu Yasayı hazırlayan Hükümetin bu girişimini selamlıyor ve onu prensipte kabul ediyoruz.

Ancak Yasa önergesi ve bakanlığın oluşması yönündeki hazırlıklarla ilgili şimdije kadarki etkinlikler bakımından şu prensipsel uyarılarımıza ortaya atmak istiyoruz:

- Bu yasa tasarısı sözkonusu olunca hiç olmassa bu geçici dönemde, gelenek ve görgü sahibi olan diğer ülkelerin benzeri yasalarına gibi kattı olarak yanaşmamak gereklidir. Yani bazı hükümler başlangıçta, Kosova diplomatik temsilciliklerinin açılmasını kolaylaştırmak amacıyla daha esnek olmalıdır,

- Misyon üyeleri yetiştirlirken, sadece sivil açıdan bakılmaması,
- Diğer topluluklara mensup kişiler olarak biz maalesef, Kosova diplomatik temsilcilikleri ve diplomatik temsilcilerin yetiştirmesini konusundaki stratejiler hakkında hiçbir bilgiye sahip değiliz,
- Şimdiye kadar, Kosova uluslararası misyon temsilcileri ve üyeleri görevlerine, Kosova dışında düzenlenen yetiştirmeye ve eğitim eylemlerine herhangibir azınlık temsilcisinin katılıp katılmadığı konusunda bizim hiçbir bilgimiz yok.

Hükümet tarafından bu uyarılarımızın nazari itibare alınacağına inanarak hepiniizi içtenlikle selamlıyorum. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!  
Fjalën e ka Besa Gaxherri, në emër të Grupit të LDD.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Zoti zëvendëskryeministër, Haziri,

Sot po diskutohet një pako e projektligjeve, që janë vërtet atribut apo pako e ligjeve bazike të një shteti demokratik, siç janë: Projektligji për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, që e patëm pak më parë; Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, si dhe Projektligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ushtarake ndërkombëtare. Domethënë, janë këto tri projektlige që i kemi sot në shqyrtim.

Edhe pse këto projektligje, dhe shumë projektligje të tjera bazike të domosdoshme për shtetin e Kosovës, janë mëse të vonuara, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me kënaqësi dhe vëmendje të posaçme i ka shqyrtuar këto projektligje dhe për Projektligin konkret për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, mund të themi se i japim përkrahje në lexim të parë, apo në shqyrtim të parë.

Ky Projektligj dhe projektligjet e tjera, të rëndësisë së veçantë politike, mendojmë se është dashur të shqyrtohen pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës, sepse nuk duhet të jetë kushtetuta produkt i ligjeve, por këto ligje që po i shqyrtojmë sot të janë produkt i kushtetutës.

Ligji në fjalë, pas dy leximeve që u bënë sot këtu pikë për pikë e nen për nen, kisha për të thënë se është kryesisht i hartuar mirë, me një strukturë të mirë dhe kuptohet se është kompatibil me ligjet e Bashkësisë Evropiane si dhe ka koston financiare që paraqet implikimet buxhetore nga viti 2007 deri në vitin 2010, zoti kryesues.

Nga kjo pasqyrë shihet se kjo Ministri tashmë është dashur të jetë në funksion, anipse nga Kuvendi i Kosovës nuk është aprovuar buxheti për këtë ministri për vitin 2007, ndërsa në këtë pasqyrë figuron se kjo ministri tashmë është dashur ta kishte filluar punën sipas asaj kostoje.

Megjithatë, në qoftë se ju keni qenë të gatshëm ta vëni në veprim këtë ministri, në këtë vit, sa u përket financave, kanë mundur të realizohen përmes procedurave të rregullta buxhetore me rishikimin të gjashtëmijorit të parë të buxhetit 2007, gjë që nuk ka ndodhur. Nga kjo, dhe shumë neglizhenca të tjera, ky Ligj nuk mund të aplikohet në vitin 2007.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, do ta japë kontributin për ta pasuar këtë Ligj edhe përmes komisioneve funksionale, zoti kryesues! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete për kontributin tuaj të veçantë!  
Fjalën e merr Ferid Agani, në emër të Grupit për Integrime.

FERID AGANI: I ndeuari zoti kryesues,  
I ndeuari zoti zëvendëskryeministër,  
Të ndeuar kolegë deputetë,  
Projektligji, i cili është paraqitur para nesh, paraqet si duket një shenjë të mirë sepse Qeveria e Kosovës ka filluar me seriozitet të marrë obligimin ligjor, i cili del nga përkrahja e Pakos së Ahtisarit nga Kuvendi i Kosovës dhe përpilimi i ligjeve përkatëse të sferave të ndryshme të jetës shoqërore.

I bashkëngjitëm mendimit të deputetës Gaxherri se parakusht për të gjitha këto ligje, të cilat kanë filluar të përgatiten nga Pakoja e Presidentit Ahtisari, ka qenë Kushtetuta e Kosovës. Është dashur që Kushtetuta e Kosovës të jetë subjekt i debatit dhe i diskutimeve në këtë Kuvend dhe prej saj të burojnë dhe të dalin të gjitha ligjet e tjera, të cilat janë të domosdoshme në procesin shtetformues të Kosovës.

Grupi Parlamentar për Integrin, natyrisht, përshëndet dhe mirëpret paraqitjen e këtij Projektligji dhe të njëjtin e mbështesim, të them, në parim.

Ajo që ka ngjallë pak huti, janë dokumentet përcjellëse, konkretisht dokumenti për ndikimin buxhetor të Projektligjit që vjen nga Ministria për Ekonomi e Financa, i cili kalkulimet buxhetore i bën në bazë të numrit prej 14 misioneve diplomatike, e ky numër askund në Projektligj nuk figuron. Në çfarë baze është bërë ky kalkulim dhe prej kah ka ardhur? Ndoshta do të kishte qenë mirë që zëvendëskryeministri të na informojë se a ka qenë kjo çështje temë debati në Komisionin Parlamentar për Marrëdhënie Ndërkombëtare apo jo. Kjo është nën një.

Nën dy, mendoj se Projektligji i ka disa mangësi në aspektin e kompetencave ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kryeministrat dhe Presidencës.

Konkretisht, nen 3 pika a) dhe h), nuk qartësojnë qartë se cilat janë kompetencat e Presidentit të Kosovës në procesin e përcaktimit të misioneve diplomatike, në procesin e përcaktimit të ambasadorëve dhe të shefave të misioneve. Janë mjaft të ngatërruara. Për shembull, ta marrim nenin 5. 2, i cili thotë: "Ambasadori ose shefi i misionit, mund t'i dërgojë raporte Presidentit, ministrit të Punëve të Jashtme, Kryeministrat e tjere". Do të thotë, mund t'i dërgojë dhe lihet në mënyrë vullnetare të bëhet kjo, edhe pse duhet të jetë një obligim i qartë.

Çështja e tretë, është çështja e të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Neni 7.1, në mënyrë ekskluzive parashev se postet vakante duhet të shpalen në bazë të Rregullores për shërbyesit civilë.

Neni 7.4 thotë se nuk është e thënë që të kufizohet vetëm në shërbyesit civilë, ndërsa nen 8.1 i parashev nominimet politike për këto poste.

Mendoj se këto duhet të qartësohen dhe të vihen në rend e të mos ketë kontradikta brenda tekstit ligjor.

Për fund, desha të ndalem te nen 7.2, të cilin e përmendi edhe zoti zëvendëskryeministri, çështja e seancave të mbyllura dëgjimore për kandidatët për postet më të larta, të ambasadorëve dhe të shefave të misioneve diplomatike. Mendoj se një prej standardeve më të larta demokratike është transparenca e proceseve të emërimit të zyrtarëve më të lartë, të funksionarëve më të lartë politikë edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe konsideroj se nuk ka kurrfarë arsy që seancat dëgjimore të kandidatëve të jenë të mbyllura për opinion sepse nuk bëhet fjalë për kurrfarë sekretesh shtetërore, por bëhet fjalë për vlerësimin e kapaciteteve, potencialeve intelektuale e politike të këtyre kandidatëve, kështu që nuk shoh ndonjë arsy të veçantë, përkundër faktit se zëvendëskryeministri e arsyetoi këtë me praktikë të ngjashme në shtetet përreth. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Kamer Kameri.

**KAMER KAMERI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Do të jem shumë i shkurtër. Kam një vërejtje te nen 3, të cilën në mënyrë të përciptë e përmendi edhe kolegu Buja.

Edhe unë mendoj se termat “kosovar” dhe “shtetas i Kosovës” kanë kuptime të ndryshme. Prandaj, te nen 3 pika 1, duhet të formulohet ndryshe. Pajtohem që kur është “qytetar i Kosovës” dhe “kosovar”, të zëvendësohet me “shtetas të Kosovës” sepse mund të mos jetë individi kosovar dhe të ketë shtetësinë e Kosovës. Prandaj, Ministria e Punëve të Jashtme obligohet t'i mbrojë të drejtat e tyre. Mund të jetë edhe e kundërtë, që të jetë kosovar e të mos e ketë, ose e ka humbur shtetësinë e Kosovës, prandaj Ministria e Punëve të Jashtme nuk mund të ketë obligime ndaj tij. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti deputet!

I fundit për diskutim është Hydajet Hyseni-Kaloshi dhe i ftoj deputetët të vijnë në sallë dhe të votojmë për Ligjin.

**HYDAJET HYSENI-KALOSHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Mbështes, natyrisht, këtë Ligj dhe s'ka si të mos mbështetet. Nuk besoj që ka ndokush se do të mund të gjente çfarëdo baze për ta kundërshtuar atë.

Ajo që unë do të dëshiroja ta theksoja dhe veçanërisht të ndalem, është mënyra si po procedohet ky Ligj dhe disa ligje të tjera, dhe mënyra si u artikulua kjo nga zëvendëskryeministri.

Ai tha, tekstualisht, siç është edhe në shkresën përcjellëse – në memorandum, se ky Projektligj nuk është konform Kornizës kushtetuese dhe prejudikoi edhe epilogun e tij.

Me këtë vendosje në pak ose tjetër, njëfarë ekzibicion që po vazhdon gjithandje, prejudikoi, po ashtu, edhe një procedurë të veçantë që është paraparë diku edhe në dispozitat përfundimtare. Kjo, nuk mund të kalojë aq lehtë, zonja e zotërinj. Pse ky konfuzion?

Qeveria duhet ta përgatiste terrenin për këtë sfidë të rëndësishme. Ne, bashkëpunojmë ose bashkëveprojmë me praninë ndërkombëtare në Kosovë dhe kjo është e institucionalizuar. Prandaj, edhe procesi i tranzicionit duhet të jetë i planifikuar dhe këtu duhet të na sillen propozime të ndërtuara me procedurën, me ecurinë e jo ne tani të vihemë në lajthitje – çka po bëjmë. Nuk mund të shesim më dushk për gogla, siç ka ndodhur deri më tanë.

Më së pari, e kontestoj seriozisht formulën që është edhe në preambulë të Ligjit, edhe në ekspozenë e zëvendëskryeministrit, sipas të cilit, ky Ligj nuk është konform me Kornizën kushtetuese. Më duhet shumë kohë për ta arsyetuar, por do ta pyesja zëvendëskryeministrin, - mbi c'bazë është në kundërshtim?

Korniza kushtetuese, si edhe Rezoluta 1244, kanë paraparë vendosjen e pranisë ndërkombëtare në Kosovë në funksion të vendosjes së normalitetit, të ngritjes së institucioneve demokratike, të bartjes së kompetencave atyre dhe në këtë mënyrë zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura. Shtatë vjet kanë kaluar, kurse kanë parashikuar tri vjet. Prandaj, është koha që Kosova të kompletojë strukturën e saj institucionale. Për më tepër, Korniza kushtetuese nuk ka asnjë dispozitë që do ta kufizonin Kosovën për të pasur Ministrinë e Jashtme. Madje, unë do të thosha, edhe ministritë e tjera, edhe Ministrinë e Mbrojtjes, pse jo. Para ndonjë viti thuhej se s'mund të ketë Kosova Ministri të Brendshme. Pse e ka? Korniza nuk përjashton asnjë ministri. Ajo thotë vetëm që Kosova duhet të qeveriset nga institucionet demokratike, ligjvënëse, ekzekutive e gjyqësore. Nuk është e drejtë ajo që të është shkruar, por është ajo e drejtë që të takon. Eventualisht, mund të jetë e kontestueshme ajo që të është ndaluar, por Kosovës as që i është ndaluar as që mund t'i ndalojë kurrë me asnjë kriter një e drejtë e tillë elementare.

Prandaj, është mirë që edhe në preambulë, edhe pse është pak kontradiktore, por edhe Zyra për Integrime Evropiane ka theksuar se nuk ka asnjë kundërshtim me standartet evropiane. Për ne, kjo është me rëndësi.

Unë, prandaj do të kërkoj dhe apeloj që ta heqim krejtësisht këtë qasje nga diskursi ynë politik. Është e gabuar, është pak edhe e papjekur, ju lutem. Po na ngatërron edhe ne, po i ngatërron edhe partnerët tanë.

Ose jemi të përgatitur dhe t'i hyjmë kësaj çështjeje, ose të mos hyjmë, siç thonë, në mal pa sopatë. Nuk janë çështje që duhet të luhen për efekte politike, ju lutem.

Për më tepër, Korniza kushtetuese edhe ua ka përshkruar institucioneve të Kosovës kompetencat parimisht në fushën e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit me jashtë. Është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës pse nuk e kanë kompletuar strukturën e vet institucionale. Ato që kanë qenë kompetenca të rezervuara, lexoni me vëmendje ju lutem, e unë mund t'iu referohem edhe dispozitave, por ju marr kohë, janë vetëm të kufizuara në fazën përfundimtare dhe në pjesën që ka të bëjë me misionin ndërkombëtar në Kosovë. Kosovës shprehimi i përfundimtare edhe i njohur e drejta për bashkëpunim ndërkombëtar, përlidhje të marrëveshjeve dhe miratim të tyre, pastaj përlidhje të popullit të Kosovës me popuj të tjera – përfshirë edhe komunitetin euroatlantik. Shprehimi i kemi në kapitullin 5-6 të Kornizës kushtetuese.

Kam edhe ndonjë vërejtje në tekstin e Ligjit, por mendoj se ato do të mund të rregullohen në procesin e amendamentimit.

Pra, me këto vërejtje, i japim mbështetje Ligjit të propozuar dhe besojmë se ai do të kalojë edhe fazën e amendamentimit dhe do të miratohet në periudhën e paraparë përfunksionimin e kësaj legjislature. Është pak për t'i bërë vërejtje Qeverisë – pse këto ligje, aq të rëndësishme, i ka sjellë në një kohë kur mund të ndodhemi në situatë të vështirë që ato të mos mund t'i miratojmë për shkak të afatit të kufizuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Diskutimi në parim për Ligjin, ka mbaruar. Unë ftoj teknikën dhe i thërras deputetët të bëhen gati për ta votuar.

I kemi 66 deputetë në sallë. Ju lus të votojmë tash. Në ndërkohë, është shtuar numri i deputetëve.

68 votojnë “për” dhe asnjë “kundër”

Konstatoj se miratohet në lexim të parë Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës.

Pas miratimit në parim që e bëmë tash, në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrime Euroatlantike, si komision funksional dhe raportues;
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese;
- Komisionin për Buxhet e Financa, dhe
- Komisionin për Komunitete.

Kolegë të nderuar, a jeni të gatshëm të vazhdojmë punën, apo të shkojmë në pushimin e mesditës dhe të vazhdojmë pastaj?

Atëherë, do të bëjmë një pushim deri në orën 14,00.

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

**KRYESUESI SABRI HAMITI:** Vazhdojmë me pikën e shtatë te rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ushtarake ndërkombëtare, si dhe personelin e saj**

Projekti u është shpërndarë me kohë deputetëve dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin e Qeverisë të Kosovës, zotin Lutfi Haziri që ta paraqes Projektligjin para deputetëve. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër!

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit!

Inderuari zoti kryesues,  
Të nderuar deputetë,

Jam i nderuar që edhe një projektligj me rëndësi të veçantë paraqes para jush, i cili ka të bëjë me nevojën e organizimit të infrastrukturës ligjore gjatë periudhës tranzitore në Kosovë dhe rregullon statusin, imunitetin dhe privilejet e misioneve diplomatike dhe konsullore, personelin e tyre në Kosovë, praninë ndërkontaktare ushtarake në Kosovë si dhe personelin e saj.

Ky Projektligj rregullon dhe qarteson statusin, imunitetin privilejet e misioneve diplomatike, konsullore duke përfshirë organizatat ndërkontaktare ndërkontakta si dhe personelin e tyre në Kosovë së bashku me personat e tjerë ndërkontaktarë të mbrojtur në përputhje me ligjin ndërkontaktar, siç është paraparë edhe në Konventën e Vjenës mbi marrëdhënet diplomatike, të datës 18 prill 61, Konventën e Vjenës mbi marrëdhënet konsullore, të datës 14 prill 63, Konventën e përgjithshme mbi privilejet dhe imunitetet e kombeve të bashkuara, të datës 13 gusht 46 si dhe Konventën mbi privilejet dhe imunitetet e agjencive të specializuara të kombeve të bashkuara, të datës 21 nëntor 47, me qëllim që të sigurohet marrëveshje kalimtare për misionet ekzistuese ndërlidhëse në Kosovë, misionet e parapara ndërkontaktare civile dhe ushtarake që do të kenë, apo do të jenë pjesë e zhvillimit të Kosovës.

Nxjerra e këtij Projektligji parashihet në Aneksin 94.6 dhe në Aneksin 11.2 të pikës 3, Propozimi gjithëpërfshirës për përfundimin e statusit të Kosovës, po ashtu.

Rregulloret e UNMIK-ut 2000/42 dhe 2000/47 të cilat aktualisht rregullojnë këtë fushë do të shfuqizohen vetëm atëherë kur të përfundojë mandati i UNMIK-ut në Kosovë, pasi të aprovohet Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, apo pasi të gjendet rruga ligjore për përmbylljen e fazës së tranzicionit në Kosovë.

Inderuari zoti kryesues,  
Të nderuar deputetë,

Ju lus që Kuvendi sot të miratojë në lexim të parë këtë Projektligj, i cili ka rëndësinë e veçantë dhe rregullon, edhe njëherë po e përmend, statusin, imunitetin dhe privilejet e misioneve diplomatike dhe konsullore, personelin e tyre, praninë ushtarake ndërkontaktare me personel, dhe komisionet përkatëse të fillojnë shqyrtimin e tij.

Procedimi i Projektligjit në Kuvend dhe fillimi i shqyrtimit sipas procedurave do të ndihmonte shumë që faza e tranzicionit në Kosovë të përballohet me lehtësi shumë të madhe. Ju faleminderit shumë!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, profesor Alush Gashi.

**ALUSH GASHI:** Ju faleminderit, zoti kryesues Hamiti! Falënderojmë ekselencën e tij, zëvendëskryeministrin për prezantimin e Projektligjit.

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet provisionet e parapara me Konventa relevante ndërkontaktare lidhur me këtë çështje. Por, Projektligji në disa raste shkon larg në përligjësimin e pafuqisë së ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës karshi plotfuqisë së pranisë ndërkontaktare në rastet e shkeljeve flagrante të ligjeve vendore.

Propozuesi shkon shumë larg kur siguron imunitet të plotë edhe ndaj nënkontraktorëve ndërkombe të apo të të punësuarve vendorë në institucionet ndërkombe të në Kosovë. Përvoja e vrasjes së demonstruesve të paarmatosur nga ana e policisë Rumune dhe trajtimi i kësaj çështjeje nga drejtësia e vendit të tyre kërkon angazhim të shtuar për formulime adekuate juridike në këtë ligj. Propozuesi ka qasje të çuditshme kur hyrjen në fuqi të ligjit e kushtëzon me miratimin e Rezolutës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së lidhur me pavarësinë e vendit tonë.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit do të jetë e mirëseardhur, por jo edhe e domosdoshme. I nderuari zoti kryesues, ne do ta vazhdojmë angazhimin tonë për miratim të ligjit ku imuniteti i pranisë së ardhshme ndërkombe të në Kosovë të jetë i frymës dhe të vlerave të kohës në të cilën jetojmë dhe mos të ketë frymën e qasjes koloniale. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zotëri Gashi!

Kryetarja e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Gjylnaze Syla,

**GJYLNAZE SYLA:** Ju faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,  
Zoti zëvendëskryeministër,  
Zoti ministër,  
Deputetë të nderuar,

Unë për këtë Projektligj do të flasë në dy aspekte, në aspektet e dispozitave të përgjithshme që kanë të bëjnë me fushëveprimin, rëndësinë e këtij Projektligji, por edhe një pjesë të përbajtjes së këtij Projektligji, të cilin e konsideroj të rëndësishëm dhe një pjesë që do ta shtroj pastaj për debat para jush që shpresoj se do të merrni pjesë në atë pjesë të debatit.

Rëndësia e këtij Projektligji është se Kosova përgatitet për marrëdhënie të plota diplomatike me shtetet e tjera. Misionet diplomatike në Kosovë formohen në parimin e reciprocitetit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe shteteve të huaja. Nevoja për ekzistimin e këtij ligji është rregullimi me ligj i kësaj fushe dhe i kësaj sfere. Qëllimi i këtij Projektligji është rregullimi i të drejtave dhe të kompetencave të misioneve diplomatike konsullore dhe të personelit në Kosovë por edhe të pranisë ushtarake ndërkombe të dhe të personelit të tyre në Kosovë. Sa i përket përbajtjes së ligjit, ai ka 12 nene dhe secili i shqyrton në mënyrë të veçantë fushat përkatëse. Projektligji në esencë rregullon mbrojtjen e diplomatëve, të konsujve, të familjeve të tyre. Po ashtu, këto imunitete të cilat i gjëzojnë do t'i kisha përkufizuar në katër kategorit.

1. Paprekshmëria, pra liria nga hetimi dhe zënia,
2. Imuniteti nga juridikioni penal në Kosovë, pra nuk mund të arrestohen ose të paraburgosen për shkeljet e ligjeve të Kosovës,
3. Imuniteti civil, nuk paditen dhe
4. Imuniteti, ku nuk iu kërkohet të jenë dëshmitarë në procedurat civile apo penale në Kosovë.

Po ashtu, misionet diplomatike përjashtohen nga të gjitha taksat dhe tatimet personale apo në pronë, kanë të drejtë importimi të mallrave dhe të shërbimeve të liruar në dogana dhe akciza ose tatimi në vlerën e shtuar. Ministria e Punëve të Jashtme pajis personelin e

misioneve diplomatike apo konsullore me kartela të identifikimit. Këto dispozita nuk vlejnë për personelin vendor.

Imunitetet dhe privilegjet e njëjta i gjëzon edhe prania ushtarake ndërkombejtare dhe kontraktuesit dhe nënkontraktuesit e tyre. Sa u përket misioneve ndërlidhëse ekzistuese në Kosovë, neni 11 përkufizon dispozitën me të cilën gjëzon statusin dhe privilegjet për 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Të gjitha këto privilegje, imunitete të cilat i përmenda janë në pajtim me ligjin ndërkombejtare, por edhe me konventat ndërkombejtare, sidomos me ato të Vjenës dhe të Kombeve të Bashkuara, të cilat ministri tashmë i përmendi.

Projektligi është po ashtu në pajtim me normat ndërkombejtare. Por, do të ndalem për një moment në vlerësimin e buxhetit. Për tri vite, nga viti 2007 - 2009 vlerësohet se nuk do të ketë ndikime të drejtëpërdrejta buxhetore në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Megjithatë, disa shpenzime shtesë mund të priten, si pajisja me kartela të identifikimit, zbritje të çmimit, lirimi nga dogana. Po ashtu, Qeveria e Kosovës do të jetë e obliguar që të sigurojë objektet publike dhe mjetet për praninë ndërkombejtare ushtarake.

Në fund, dëshiroj të adresoj atë që thashë në fillim të prezantimit tim lidhur me debatin. Vështirësia fundamentale mund të jetë ajo konceptuale, se a duhet privilegjet, imunitetet e cekura në këtë ligj dhe të definuara për diplomatët e misioneve diplomatike dhe konsullore të jenë të njëjta me ato të përfaqësuesve ndërkombejtare të cilët kanë funksione të ndryshme nga ato që kanë misione diplomatike. Prandaj, unë ju ftoj lidhur me këtë që të shprehni mendimet tuaja se cili koncept duhet të dominojë.

A ka kuptim që ndryshimet të cilat ekzistojnë në mes tyre, në mes të emisioneve diplomatike dhe atyre ndërkombejtare të trajtohen në mënyrë të njëjtë. Në fund, dua të mbështesë, gjithashtu, kolegut tim Alush Gashi se a duhet të jenë të privilegjuar dhe t'i shkelin dispozitat ligjore të Kosovës edhe nënkontraktorët për punën të cilën do ta bëjnë. Në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet, por gjithnjë duke i marrë parasysh vërejtjet të cilat unë i bëra. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja Syla!  
Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Jakup Krasniqi.

**JAKUP KRASNIQI:** Zoti kryesues,

Zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ne vërtet nuk kemi si të mos e përvihendetim ardhjen e këtij Projektligji në Parlamentin e Kosovës dhe diskutimin për të, në parim. Por, dua të them se ngjashëm sikur që u tha sidomos nga Hydajet Hyseni për ligjin paraprak, në një masë të madhe vlen edhe për këtë ligj, ku ende pa e formuar një ministri, po e kufizojmë fushëveprimtarinë e saj dhe gati po e bëjmë të pa mundshëm funksionimin e saj. Në një mënyrë, po e bëjmë ministri për të paguar ministra dhe administratë, por nuk po bëjmë ministri për të ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Kështu është rasti edhe me këtë ligj për misionet diplomatike. Nuk kemi ne çka zbulojmë të re. Janë ligjet, është imuniteti i përfaqësuesve diplomatikë në vendet e ndryshme të botës dhe ato rregulla e ato standarde që i kanë vendet e tjera, duhet të jenë edhe për diplomatët që ushtrojnë fushëveprimtarinë e vet në Kosovë.

Ne si grup parlamentar do ta japim kontributin tonë edhe në punën e komisioneve, por dua në këtë rast ta tërheq vërejtjen se deri më tanë për përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare, të administratës të lartë dhe të ulët ndërkombëtare, për përfaqësuesit diplomatikë nuk ka pasur asnjë ligj dhe asnjë rregull, nuk ka ekzistuar asnjë normë dhe kjo praktikë i ka dëmtuar shumë proceset politike në Kosovë, ka dëmtuar shumë sundimin e ligjit në Kosovë, ka dëmtuar shumë sidomos perspektivën e zhvillimit dhe të sigurisë në Kosovë. Nuk është mirë që askush tanë e tutje të ketë të drejtat e pakufishme që nuk i ka as në vendet nga vinë dhe në asnjë vend tjetër, as të Evropës, as të botës demokratike. Prandaj, ne si grup parlamentar do të japim kontributin tonë për të bërë një ligj që është në përputhje me standardet, jo diçka që është e veçantë për të huajt që janë në Kosovë. Në fund të fundit, ligji duhet të vlejë për të gjithë, dhe ata që donë të importojnë demokraci, duhet të importojnë edhe mënyrën se si respektohet dhe si sundon ligji. Deri më tanë kjo nuk ka qenë. Ne duhet të angazhohemi që ta ndërpremë këtë praktikë që ka dëmtuar, kurse Qeveria ose duhet të marrë përgjegjësi dhe kompetenca ose duhet t'i lë ato dhe t'ua lë përgjegjësitë atyre që i ushtrojnë. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Krasniqi!

Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të ORA-s, Teuta Sahatqija.

**TEUTA SAHATQIJA:** Ju faleminderit!

Sot kemi të bëjmë me ligjin e tretë i cili hyn në fushëveprimin e ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit dhe me këtë përsëri po tregojmë vazhdimësinë dhe përkushtimin tonë për përgatitjen e Kosovës për shtetin e ardhshëm të Kosovës. Prandaj, si grup parlamentar e mirëpresim këtë ligj, por fjalimi im edhe diskutimi im është bukur në koherencë me diskutimet paraprake. Çështja të cilën edhe ne si grup parlamentar dëshirojmë të cekim është se në këtë ligj ekzistojnë ato imunitete të cilat dyshoj që ekzistojnë edhe në vendet e tjera. Prandaj, kërkojmë që statusi i diplomatit në Kosovë t'u njihet të gjithë atyre të cilëve paraprakisht ky status iu është njojur dhe vlen edhe në vendet e tyre. Konform kësaj, mund të diskutojmë për nenin 3.2 dhe nenin 3.3. ku bëhet fjalë për njojjen e të drejtës së statusit diplomatik dhe konsullor, ku në mënyrë taksative numërohen agjencionet dhe organizatat të cilave iu njihet kjo e drejtë. Aty janë Kombet e Bashkuara dhe të gjitha agjpcionet që dalin prej tyre, është OSCE-ja dhe të gjitha të tjerat.

I gjithë ky numër i njerëzve të cilëve do t'u njihet ky statusi diplomatik, do të janë të liruar prej të gjitha taksave, do të janë të liruar prej doganave, prej tatimeve, prej pagesave të ndryshme e të tjera, për ç'arsye Buxheti i Kosovës mund të ketë një ngarkesë bukur të madhe. Përveç kësaj, kur kemi të bëjmë me statusin diplomatik edhe statusin e privilegjuar të këtyre përfaqësuesve që do ta kenë shtetin e Kosovës, këtë dyshim tonin apo këtë kërkësë që të ketë shumë më tepër kujdes, e bazojmë edhe në ngjarjet edhe në ndodhitë gjatë këtyre 8 viteve. Ato janë rastet e shumta të keqpërdorimit të parave nga njerëzit të cilëve iu ka njoh statusi diplomatik nëpër ndërmarrje publike e të tjera. U përmend edhe vrasja e dy qytetarëve tanë për të cilët nuk kemi pasur kompetenca për çfarëdo ndjekjeje penale apo çfarëdo intervenimi aty. Pastaj, e fundit ishte kufizimi i fjalës së lirë në Gjykatë e të tjerat raste na bëjnë me dije që, kur kemi të bëjmë me këtë ligj, duhet të kemi me të vërtetë kujdes në mënyrë që ky ligj të jetë konform standardeve ndërkombëtare dhe të jetë ligj i cili me të vërtetë do t'i privilegiojë ata të cilët e meritojnë të privilegjohen, por ligj i cili duhet të ketë kujdes në sanksionimin e atyre të cilët i keqpërdorin këto privilegje të cilat ua cakton ky ligj. Por, sidoqoftë, mendojmë që këto mund të rregullohen gjatë amendamentimit në komisionin funksional dhe ne si grup parlamentar e mbështesim këtë ligj dhe kontributin do ta japim në vazhdim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Sahatqija!  
Fjalën e ka zoti Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

XHEZAIR MURATI: Poštovani predsedavajući,  
Gospodine zamenice premijera, zaminiće ministra, kolege,

Parlamentarna Grupa 6+ je pažljivo razmotrila i ovaj zakon o statusu i imunitetu i privilegijama diplomatskih i konzularnih misija i osoblja na Kosovu. Ova problematika je do sada, kao što znamo, bila regulisana mnogim uredbama UNMIK-a, te se o efektima ovog zakona može govoriti kada ta misija završi mandat. S toga, neophodno je pripremanje ovog zakona i veoma je bitno da ga Agencija za evropske integracije kao takvog podržava, što znači ne sukladja se sa interesima ove agencije kao i sa interesima međunarodne misije. Za to je njegova opravdanost potpuna, jer će na vreme da potpuni vakum koji bi nastao u prelaznom, odnosno tanzicionom periodu nakon usvajanja Rezolucije u Savetu bezbednosti. Svakako je da u njegovom sadržaju, čija je osnova dosta dobra, ima nekih nejasnoća i nedorečenosti, ali ovo je prilika da kažemo da ga Parlamentarna grupa 6+ u osnovi podržava, nadajući se da će ubrzo doći vreme njegove primene i realizacije. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!  
Fjalën e ka zoti Fadil Geci, në emër të LDD-së.

FADIL GECI: Ju faleminderit!

Inderuari kryesues,  
Tënderuar deputetë,

Vërejtjet që dhanë kolegët qëndrojnë dhe do të mundohem që të mos i përsëris. Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, është njëri ndër projektligjet shumë të rëndësishme për shtetin e Kosovës. Kjo lëmi deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut. Tani duhet të pushojë mandati i tyre, e për të mos pasur vakumin juridik në këtë fushë, është nevoja që ky ligj të aprovohet. Lidhja Demokratike e Dardanisë përkrah në parim dhe mendojmë se Qeveria jonë do t'i përdorë të gjitha mundësitë e saj për të vënë në dispozicion të pranisë ndërkombëtare ushtarake dhe të personelit të saj objektet e saj. Është shumë me rëndësi dhe vlen të theksohet edhe deklarata mbi pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së. Me Projektligjin për statusin e imunitetit dhe privilegjet e misioneve diplomatike në Kosovë, Kosova mbush vakumin ligjor në drejtim të formimit të shtetit të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Dardanisë do të japë mundin e vet në komisione që Projektligji të jetë më komplet dhe funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Geci!

Fjalën e ka Ferid Agani, në emër të Grupit për Integrime. I thërras deputetët të bëhen gati dhe të votojnë, le të hyjnë në sallë kush është jashtë.

FERID AGANI: Inderuari zotëri kryesues,  
Inderuari zëvendëskryeministër,  
Tënderuar kolegë deputetë,

Ligji i tretë nga Pakoja e Ahtisarit paraqet vazhdimësi të angazhimeve të Qeverisë që të rregullojë një segment të ndjeshëm të jetës shoqërore dhe politike në Kosovë, por mendoj me një sukses shumë të dobët është bërë kjo punë, krahasuar me ato dy ligjet e para. Mendoj se ky Projektligj ka mangësi me të vërtetë serioze. Disa nga parafolësit i përmendën. Unë këtu para vetes në mesin e materialit të punës e kam edhe një letër të cilën e ka dërguar shefi i Zyrës Belge në Prishtinë, një letër të cilën e ka dërguar pas konsultimit me kolegët e tij udhëheqës së zyrave ndërkombëtare, i cili e vlerëson Projektligjin si shumë të mangët dhe si projektligj i cili ngatërron shumë koncepte sa i përket prezencës ndërkombëtare në Kosovë. Nuk mund të mos pajtohem me këtë konstatim, sepse edhe leximi sipërfaqësor i këtij projektligji shumë shpejt dëshmon se konceptet në këtë projektligj janë të ngatërruara. Shihni vetëm titullin e Projektligjit, - Projektligji mbi statusin, imunititet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj.

Menjëherë në preambulë, dy reshta më poshtë thotë: "Duke përfshirë edhe misionet e organizatave ndërkombëtare ndërreveritare dhe personelin e tyre në Kosovë bashkë me personat e tjera të mbrojtur ndërkombëtarisht...". Pra, qysh në fillim vetë titulli i Projektligjit e dëshmon një konfuzion lidhur me atë se cilin segment po e rregullojmë.

Prezenca ndërkombëtare në Kosovë do të jetë shumë komplekse në periudhën pas vendosjes së statusit. Do të kemi diplomatë dhe konsuj që do të përfaqësojnë qeveritë e tyre dhe në njëfarë mënyre do të reflektojnë marrëdhëniet e shtetit me shtet që paraqet një lloj të prezencës ndërkombëtare. Do të kemi stafin e Kombeve të Bashkuara ose të OSBE-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare të cilat qeverisin ose të cilat e zhvillojnë punën e tyre nën mandatin e konventave të vitit 1946 dhe 1947. Pra, dokumentet ndërkombëtare të cilat rregullojnë funksionimin e tyre, të cilave edhe Kosova iu nënshtronhet. Në qoftë se statusi përfundimtar i Kosovës zgjidhet në bazë të propozimit gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari, dokument të cilin ky Kuvend e ka miratuar, do të kemi edhe Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil, si dhe Misionin Evropian për Siguri dhe Mbrotje, njëkohësisht me prezencën ndërkombëtare ushtarake. Pra, tri lloje specifike të prezencës ndërkombëtare në Kosovë dhe secila prej tyre imponon që çështja e statusit, të imunititetit dhe të privilegjeve të tyre të shqyrtohet në mënyrë të veçantë.

Pra, në parim, edhe grapi ynë parlamentar, duke marrë parasysh momentin politik, e mbështet këtë Projektligj, por duke tërhequr vërejtjen se para komisionit funksional, i cili do ta shqyrtojë, është një punë shumë serioze, punë e madhe për ta prurë në kuadër të standardeve ndërkombëtare të këtyre projektligjeve. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Kolegë të çmuar,  
Tani do ta hedhim në votim miratimin, në parim, të Projektligjit për statutin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ushtarake ndërkombëtare si dhe personelin e saj,

Votojmë ligjin në parim. Ju lutem, të bëhem i gati.

Votojmë tash:

Për.....62,  
Kundër....0,  
Abstenim 2.

Miratohet Projektligji në lexim të parë.

Në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon këto Komisione për punë të mëtutjeshme rrëth ligjit:

- Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimë Euroatlantike, si komision funksional dhe raportues;
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
- Komisionin për Komunitetë.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

#### **- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 14 shtator 2007 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Projektligjin para deputetëve do ta paraqesë zëvendëskryeministri Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Qeverisë si sponsor i këtij ligji dhe në mungesë të ministrit të Arsimit, zotit Veliu, i cili është me detyrë jashtë Prishtinës, paraqes para jush me respekt të veçantë këtë projektligji, i cili nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë intensivisht është punuar në përgatitjen e bazës ligjore dhe nënligjore për avancimin e procesit edukativo arsimor në fryshtë e integrimeve rajonale dhe evropiane.

Fushëveprimi i këtij ligji është rregullimi normativ i organizimit, të përbajtjes, të kushteve, të kritereve dhe të procedurave të provimit përfundimtar dhe të maturës në Kosovë. Duke pas parasysh se kjo fushë ka qenë pjesërisht e rregulluar me Udhëzim administrativ, lindi nevoja e hartimit të Projektligjit, i cili do të mbulonte tërësisht këtë problematikë. Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës krijon obligime ligjore për shumë subjekte që nuk do të mund të krijonin obligime dhe përgjegjësi të tillë. Subjektet e tillë janë Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës, Qendra e Vlerësimit, institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, drejtoria komunale të arsimit, komisionet vlerësuese të shkollave, qendrat e testimit si dhe këshillat e provimit të shkollave.

Duke pasur parasysh se shumica e çështjeve me interes për institucionet dhe qytetarët zakonisht rregullohen me ligj, kjo përkon edhe me atë se ligjet janë tërësi e rregullave të cilat përcaktojnë obligimet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe të individëve në shoqëri. Në rastin konkret, ndërhyrja e Ministrisë përmes Ligjit të maturës është bërë për shkak se ekziston mungesë e legjislacionit parësor, vlerësimet e ekspertëve për domosdoshmërinë e ekzistimit të ligjit të veçantë mbi maturën, pamundësia e organizimit të tillë të provimit të maturës me akte nënligjore dhe nevoja e zbatimit të dispozitave ligjore të cilat janë në pajtim me standarde ndërkombëtare që rregullojnë fushën e provimit të maturës.

Qëllimi i Projektligjit është rregullimi normativ i organizimit, të përbajtjes, të kushteve, të kritereve dhe të procedurave të provimit përfundimtar të maturës në Kosovë.

Me miratimin e Projektligjit të provimit përfundimtar dhe të maturës do të krijohet një infrastrukturë ligjore për organizimin, përbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe të maturës në Kosovë me qëllim të heqjes së dilemave rreth padrejtësive në provime pranuese, sepse provimi i maturës do të organizohet në shkallë më të lartë të transparencës dhe të sigurisë së kryerjes së këtij provimi pa ndërhyrje anash dhe pa pasur mundësi intervenimi për raste individuale, sepse teksti do të jetë unik për tërë territorin e Kosovës. Rëndësia e këtij projektligji është heqja graduale e organizimit të provimeve pranuese nga institucionet e arsimit të lartë, duke organizuar në mënyrë të përbashkët nga Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës provimin e maturës.

Risi e këtij Projektligji është heqja graduale e organizimit të provimeve pranuese nga institucionet e arsimit të lartë duke ia kaluar kompetencat edhe njëherë Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës. Në vitin akademik 2008/9 Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës do t'i kalojnë 50% të kompetencave. Në vitin akademik 2009/2010 Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës do t'i kalojnë 70% të kompetencave dhe në vitin akademik 2010-2011 Komisioni Qendror do të marrë 100% të drejtës dhe të ushtrimit të kompetencave.

Ky projektligj është hartuar në përputhje me Kornizën Kushtetuese si dhe legjislacionin që është në zbatim në vendet e BE-së. Si model i veçantë përmendet Sllovenia, por edhe e vende të tjera që aspirojnë në integrime evropiane, çfarë është Kosova, por si model i referohet Shqipërisë, Kroacisë dhe vendeve në region. Sipas paralogarive të thjeshta të bëra nga ekspertët është vlerësuar se buxheti i MASHT-it duhet të rritet për këto vite akademike sipas këtij vlerësimit:

Në vitin akademik 2008/9 do të ketë 20 mijë kandidatë me participim. Në vitin akademik 2009/10 22 mijë kandidatë me participim prej 10 eurosh, dhe në vitin akademik 2010/11 do të ketë 24 mijë kandidatë me participim prej 10 eurosh. Kjo shumë e mjeteve do të përdoret për: mbulimin e shpenzimeve të hartimit të testeve, pagesën e ekspertëve, të lëndëve, të përgatitjes, të shtypjes dhe të shpërndarjes së këtyre testeve, pagesën e komisioneve, të administratorëve dhe të vëzhguesve, si dhe të shpenzimeve të tjera të domosdoshme.

Të nderuar deputetë,  
I nderuari zoti kryesues,  
Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë u shpreh falënderime të sinqerta të gjithë atyre që kanë kontribuar në pasurimin e këtij Projektligji dhe ju lut që ta miratoni në leximin e parë këtë Projektligj. Ju faleminderit shumë!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!  
Tani deputetja Sanje Aliaj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sanje Aliaj, apo kush flet në emër të LDK-së. Naxhije Doçi e ka fjalën

**NAXHIJE DOÇI:** I nderuari zoti kryesues,  
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,  
Kolegë të nderuar deputetë, mysafirë dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka mirëpritur si shumë të nevojshëm Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës dhe pas një shqyrtimi të duhur që i ka bërë këtij

projektligji ka vlerësuar lartë punën dhe kontributin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë për hartimin dhe prezantimin e tij në Parlamentin e Kosovës. Përkujdesja jonë përmes rregullave të reformuara për nxënësit tanë në Kosovë që ata të pajisen sa më shumë dhe sa më mirë me dituri gjithëpërfshirëse dhe me edukim të kulturuar të niveleve të vendeve demokratike, është obligim yni shtetëror si Kosovë. Kujtoj se një përkujdesje e tillë është në rrugë të drejtë të rregullimit dhe të finalizimit sepse është krijuar një infrastrukturë e begatshme ligjore për çështje të arsimit.

Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës e ka rëndësinë e vet të pakontestueshme duke u vlerësuar si i domosdoshëm sepse rregullon mënyrën e organizimit dhe të gjitha procedurat e tjera të nevojshme për provimin përfundimtar dhe maturës në Kosovë, në pajtim me standardet ndërkombëtare. Deri më tani një çështje e tillë tek ne në Kosovë nuk ka qenë e rregulluar me ligj, pos në pikëpamje të pjesërishme me Udhëzim administrativ.

Përmes strukturës së rregulluar mirë të këtij Projektligji do të krijohet një shkallë e lartë e sigurisë gjatë kryerjes së provimit përfundimtar dhe të maturës, si dhe do të hiqen dilemat dhe padrejtësitet e mundshme ngase testet për provimet e tillë do të janë unike për tërë Kosovën dhe nuk do të ketë mundësi intervenimi për raste individuale.

Rezultatet e provimit të maturës do të janë mundësia e vetme e regjistrimit të nxënësve në institucionin e lartë të arsimit, duke i eliminuar në mënyrë të shkallëzuar provimet pranuese të deritanishme për regjistrim. Me këtë Projektligj irregullohen edhe obligimet dhe përgjegjësitë e individëve dhe të subjekteve arsimore, duke filluar që nga niveli më i lartë ministritor e deri te shkolla, e që në projektligj numërohen tetë subjekte të tillë arsimore me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të provimit përfundimtar dhe të maturës.

Ky projektligj është i hartuar në harmoni me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe nuk i cenon në asnjë mënyrë parimet themelore të këtij legjislacioni. Projektligji është i rëndësishëm sepse shpenzimet do të mbulohen edhe përmes të hyrave që do të realizohen nga pjesëmarrja e kandidatëve për pagesën e provimit përfundimtar dhe të maturës të paraparë veç e veç nga 10 euro për secilin provim.

Krahas vlerësimeve të mira në këtë Projektligj, do t'i theksoj edhe disa çështje që mendoj se do të ndikojnë pozitivisht në plotësimin e tij.

Në nenin 31 theksohet dhënia e certifikatës dhe e diplomës, por nuk theksohet se çka shkruan në to, me çfarë suksesi e ka kryer nxënësi dhe a vlerësohet me nota apo me pikë suksesi i arritur. Pra, mendoj se kjo çështje ose duhet të definohet më mirë me dispozita të këtij Projektligji, ose duhet të irregullohet me Udhëzim administrativ.

Gjithashtu, nuk është dhënë asnjë fjalë për shkolla private se si do të organizohet provimi përfundimtar dhe i maturës në këto shkolla dhe se a vlen e njëjtë procedurë e bashkëpunimit e shkollave private me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë posa në shkollat publike.

Krahas kësaj, nuk është cekur se a vlen për nxënësit që e kryejnë provimin përfundimtar të maturës në shkollat publike njësoj për t'u regjistruar si në universitetin publik, ashtu edhe në atë privat.

Kujtoj se këto gjëra është e nevojshme për t'u sqaruar më konkretisht. Krahas kësaj, po theksoj se është mirë që këtij Projektligji t'i bëhet një lekturë, sepse ka gabime gjuhësore, si drejtshkrimore, ashtu edhe sintaksore dhe ka edhe kalke që duhet të përmirësohen.

Në fund, Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim i jep përkrahje të plotë Projektligjit për provimin përfundimtar të maturës për procedim të mëtejmë, me bindje të plotë se në komisionin funksional do të eliminohen mangësitë elementare që do t'ia zvogëlonin pa arsyе rëndësinë e madhe që ka Projektligji si i tillë. Ju faleminderit, zoti kryesues!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja deputete!

Deputetja Sala Ahmetaj flet në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

**SALA AHMETAJ:** Përshëndes kryesuesin e seancës, zëvendëskryeministrin, deputetët dhe të gjithë të pranishmit në sallë.

Projektligji për provimin përfundimtar dhe për maturën, e themi qartë se ka për qëllim normëzimin dhe standardizimin e kritereve vlerësuese të dijes. Prandaj, nxenësit që mbarojnë shkollën e mesme do të shpresojmë se do të vlerësohen sipas kritereve standardizuese. Bartësit e organizimit të veprimtarisë më të rëndësishme dhe më domethënëse për rininë, siç është provimi i maturës, kanë përgjegjësi të lartë, prandaj edhe në ligj duhet të qartësohen mirë detyrat e secilit institucion dhe të të gjitha komisioneve që janë të përfshira për ta përbushur këtë mision.

Ligin për maturën e kanë edhe disa vende të Evropës. Edhe ky ligj që e kemi në duar, me gjithë vërejtjet që kemi, mund të miratohet në parim, por mbetet që komisioni përkatës të bëjë amendamentimin e disa neneve dhe të mënjanjojë disa paqartësi të dukshme dhe të theksuara, sidomos rrëth funksionimit dhe strukturës së Qendrës Kombëtare të Vlerësimit. Pastaj, paqartësi ka edhe rrëth funksionimit dhe përgjegjësisë së Komisionit Qendror Shtetëror dhe të atij të drejtorisë komunale të arsimit, e cila ka të bëjë me komisionet, vëzhguesit dhe me veprimtari të tjera që organizohen për maturën. Kemi vërejtje edhe për nenin 7 dhe 8 rrëth mënyrës së krijimit të Komisionit Qendror Shtetëror. Natyrisht, po të arrinim që përsosshmërisht të organizohen provimet e maturës, vlerat dhe dija do të konkuronin ndershëm në Universitet, pa provim pranues, e ky do të duhej të ishte qëllimi i këtij ligji. Ne i kemi edhe disa vërejtje të tjera, sidomos rrëth faktit se provimi i diplomës a duhet të jetë unik për tërë Kosovën, për të gjitha institucionet e arsimit që veprojnë në Kosovë, si për ato të arsimit privat, ashtu edhe për ato të arsimit publik. Por, shpresojmë se këto çështje do t'i rregullojmë në komision gjatë amendamentimit të tij. Në parim, Partia Demokratike e Kosovës e përkrah këtë Projektligj, kurse vërejtjet tona që i kemi do t'i paraqesim në komision.

Kemi edhe një dilemë. Në Projektligj është paraparë që organizimi i maturës të fillojë në vitin 2008. Kemi frikë se do të jetë shumë vështirë të bëhet zbatimi në mënyrë korrekte i këtij ligji në vitin e ardhshëm, sepse është vështirë të bëhen përgatitjet paraprake, siç është hartimi i testeve e i gjërave të tjera. Ju falënderojmë për vëmendjen!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja Ahmetaj!

Deputetja Myrvete Dreshaj-Baliu do të flasë në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

**MYRVETE DRESHAJ-BALIU:** Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për provimin përfundimtar të maturës, të cilin po e diskutojmë sot, paraqet njërin prej projektligjeve të rëndësishme që janë përgatitur nga Ministria e Arsimit. Ky projektligj gjithsesi paraqet edhe një hap të rëndësishëm në rrugën e reformave të cilat po realizohen me qëllim të përmbylljes sa më të suksesshme të këtij procesi në arsimin fillor dhe të mesëm.

Megjithëse ne nuk kishim deri më tash një ligj të kësaj përbajtjeje, ndërsa provimi përfundimtar dhe i maturës irregullohej me një udhëzim administrativ, ky Projektligj mbulon tërësisht këtë fushë dhe natyrisht iu krijon kushteve institucioneve arsimore dhe qeveritare për të marrë detyra dhe përgjegjësi shtesë. Sigurisht, Projektligji, duke qenë në fazën e parë të diskutimit, ka edhe vend për rishqyrtim. Bie fjala, në nenin 8 pika 3 thuhet se Komisionin Qendror Shtetëror të Maturës e përbëjnë 9 anëtarë, dy nga Ministria, tre nga Universiteti, një nga Akademia e Shkencave, e tjera. Por, mungon përfaqësuesi i Institutit të Pedagogjisë. Nuk e di pse do të angazhohej Akademia në një komision të maturës e të anashkalohej Institutit përkatës i kësaj fushe. Prandaj, propozojmë që vendin e përfaqësuesit të Akademisë ta zë përfaqësuesi i Institutit Pedagogjik. Gjithashtu, po në këtë pikë propozohet që në Komisionin Qendror të jenë tre përfaqësues nga Universiteti, e unë propozoj që të theksohet në mënyrë të veçantë që njëri prej tyre të jetë nga Fakulteti i Edukimit.

Po kështu mund të veçojmë edhe nenin 19 pika 5 në të cilën, përveç tjershës thuhet, citojmë: "Rezultatin përfundimtar të arritshmërisë së nxënësve e përbëjnë a) 40% rezultatet e arritura gjatë viteve të shkollës së mesme, si vlerësim i brendshëm, dhe nën b) 60% rezultatet e arritura nga provimi i maturës, si vlerësim i jashtëm." Ndërsa unë mendoj se mund të përdorim disa metoda vlerësimi, por në asnjë rast nuk do të duhej të lejonim që rezultati i kalueshmërisë të jetë rreptësishtë vetëm peng i provimit përfundimtar dhe i maturës, e kjo do të thotë se duhet të kishim jo 40% me 60%, por të kundërtën, ose si është në projektligj, por kuota e përcaktuar ndoshta do të ishte më mirë që ta arrihej gjatë fazave të zhvillimit të saj.

Edhe në këtë Projektligj kemi nevojë të rishikojmë edhe reflektimin e sforcuar të provimit përfundimtar dhe të provimit të maturës si oponencë e provimit pranues nga institucionet e arsimit të lartë universitar, duke pasur parasysh vazhdimisht profilizimet. Edhe gjuha e tekstit të projektligjit duhet të rishikohet. Megjithatë, këtë projektligj AAK e sheh si një nga përbërësit e rëndësishëm në krijimin e infrastrukturës ligjore, rregullimin, organizimin përbajtjen, kriteret, procedurat e provimit përfundimtar dhe të provimit të maturës. Duke lënë mundësinë që kontributin tonë ta japim në komisionin funksional, theksoj edhe njëherë se AAK e përkrah në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja Dreshaj-Baliu!  
Në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s flet Genc Gorani.

**GENC GORANI:** Ju faleminderit!  
I nderuari zoti kryesues,  
Anëtarë të qeverisë,  
Të nderuara zonja dhe zotërinj deputet,

Grupi Parlamentar ORA e mirëpret ardhjen e këtij Projektligji për shqyrtim dhe miratim. Besoj se e ndajmë konstatimin e përbashkët se ky Projektligj është dashur të propozohet shumë më herët, ka mundur të propozohet shumë më herët, po ashtu. Arsyen përvonesë nuk shoh, ndërsa përfitimet janë evidente.

I kemi edhe disa vërejtje të tjera konkrete në lidhje me dispozitat e këtij Projektligji. Sa i përket nenit 5, kur flitet për kandidatët, thuhet se kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta dhe kandidatët e arsimit për të rritur, do të përcaktohen me akte nënligjore të veçanta. Dua të theksoj se në nenin 5 duhet të përcaktohet edhe afati i kompletimit të akteve nënligjore mbi kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta. Thjesht, është praktikë tepër e zakonshme që Ligji të fillojë të zbatohet pa u kompletuar pjesa e infrastrukturës së ligjeve, do të thotë të akteve nënligjore të veçanta.

Në nenin 6, ku flitet për kandidatët e kthyer nga jashtë, mua më duket ky formulim jo i saktë dhe jo fort fatlum. Termi: "kandidati i kthyer" duhet të zëvendësohet me një term më të saktë, sepse në esencë nenet në vijim nuk kanë të bëjnë me kandidatët nga jashtë, por me ata të cilët posedojnë dëftesa të barasvlershme me ato në Kosovë, ato që mund të nostrifikohen dhe që kërkojnë të hyjnë në provimet në fjalë.

Në nenin 20, ku flitet për obligimet e arsimit të lartë, neve na duket se me nenin 20, e kemi bindjen ashtu, në fakt hyhet në një reformë mjaft të rëndësishme për regjistrimin në shkollim të lartë, ku dhënia e provimit të maturës do të jetë e domosdoshme. Në të njëjtën kohë, institucionet e arsimit të lartë obligohen t'i heqin provimet pranuese. Me këto 4 nene, faktikisht ne hyjmë në një reformë të rëndësishme.

Mendoj, se kjo në vete meriton një kohë më të gjatë të refleksionit për këtë reformim. Nuk më duket mjaft e qartë nga këto dispozita se a vlejnë këto dispozita edhe për arsimin privat dhe a ka përashtime. Nuk besoj se aq thjesht, me kaq pak dispozita, në mënyrë relativisht të përgjithshme mund të mbulohet kjo sferë në mënyrë të saktë. Por, shpresoj dhe besoj, se në kuadër të komisionit ne mund ta kompletojmë këtë sferë, nëse e identifikojmë se nevoja ekziston me të vërtetë.

Grupi Parlamentar ORA përkrah në parim këtë Projektligj dhe mendoj se Komisioni për Arsim do të ketë punë serioze për ta kompletuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Gorani!

Deputeti Ramadan Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

**RAMADAN KELMENDI:** Ju faleminderit!

Inderuari kryesues,  
Të nderuar ministra,  
Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së pasi që bëri shqyrtimin e Propozimligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës, vlerësoi se në parim përkrah në shqyrtimin e parë, ngase Propozimligji përcakton bazën themelore të organizimit, të përbajtjes, kushtet dhe kriteret, si dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe të mbrojtjes së maturës në Kosovë. Duke përcaktuar edhe autoritetet shtetërore, përgjegjëse për këtë çështje, si dhe

subjektet e tjera të bashkëpunimit me të cilat, si duket, realizohet qëllimi, por edhe komplikohet sadopak procesi i organizimit të provimit të maturës si dhe vënia në shprehje e një lloj burokratizimit në funksionimin e organizimit të tërë procesit të provimit të maturës. Megjithëkëtë, anët e tjera janë pozitive.

Nëse provimi i maturës do të arrihet që ta heqë provimin pranues në fakultet, siç paraqet qëllimi i këtij Propozimligji, atëherë duhet ndryshuar pjesërisht Ligjin mbi arsimin e lartë në dispozitat që këtë e kërkojnë.

Vlerësojmë se kostoja e buxhetit të këtij Propozimligji është e ndjeshme për buxhetin e Kosovës, por e arsyeton qëllimin. Kjo kosto do të reflektohet edhe në buxhetin familjar të maturantëve, gjendja sociale-ekonomike e të cilëve edhe kështu është e rëndë, andaj paga prej 10 eurosh për provim dhe 10 euro është maturë dhe për paraqitje, është pak sa e lartë dhe rezulton që domosdoshmëria për pagë të jetë më simbolike, më e arsyeshme dhe më e kapshme për buxhetin tonë.

I tërë procesi i provimit të maturës dhe i provimit pranues në Universitet, do të krijonte paqartësi të cilat qysh tani duhet eliminuar, ngase edhe vetë struktura e funksionimit të Komisionit Qendoror Shtetëror, të Qendrës së vlerësimit të Drejtorisë komunale të Arsimit, të Komisionit Qendoror të Testit, të Komisionit vlerësues të shkollës, të Këshillit për provimin e lëndës së diplomës dhe paraqitjes së raportit të saj mes temës e diplomës, krijojnë burokratizim të vogël brenda vetë organizimit. Ne mendojmë se titulli i Propozimligjit duhet riformular, sepse ka ndryshime në mes provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së maturës, nga se kjo rezulton se titulli i Propozimligjit, natyrisht do të duhej të ishte: "Për mbrojtjen e maturës". Edhe ky Propozimligj, bazueshmërinë juridike e mbështet në rregullore, në vend se të fillojë me Kornizën kushtetuese, ashtu siç duhet dhe ashtu siç është Vendimi i Kuvendit të Kosovës qysh më parë.

Grupi Parlamentar i LDD-së, vlerëson se në këtë Propozimligj nuk është rregulluar çështja e barasvlerës së dëftesave të marra nga kandidatët jashtë Kosovës me ato vendore, dhe i kthyeri i nënshtrohet provimit vetëm aty ku cakton Drejtoria e arsimit, dhe kjo do të krijojë probleme në aplikim.

Shikuar në tërësi, raporti hierarkik në mes të kompetencave të Komisionit Qendoror Shtetëror të Maturës e deri te Këshilli i provimit në shkollë, lë përshtypje, po e përsërisë disa here, të një burokratizimi të tepruar të funksionalizimit të procesit mbi dhënien e provimit përfundimtar dhe të maturës.

Propozmligji nuk jep përgjigje në rastet kur kandidati e kryen provimin e maturës dhe nuk mund të regjistrohet në fakultetin që dëshiron, apo në fakultet fare. Ne mendojmë se me rastin e paraqitjes së provimit përfundimtar dhe të maturës, është kërkesë e tepruar, që për çdo rast të kërkohet certifikata e lindjes, po e zëmë si dokument, kur ajo është në dokumentacionin e shkollës qysh nga fillimi kur është regjistruar kandidati dhe vlera e dokumentacionit është e përhershme. Së paku kështu është proklamuar. Kjo merr kohë dhe krijon shpenzime buxhetore.

Ana më e padefinuar në kuptimin juridik të këtij Propozimligji, është nen 33 - sanksionet të cilat vlerësojmë se duhet të riformullohen në mënyrë të qartë, për të mos lënë mundësi të interpretimeve subjektive. Me gjithë këto sugjerime, Grupi Parlamentar i

LDD-së përkrah miratimin në parim, në lexim të parë, duke u angazhuar që përmes komisionit funksional, t'i paraqesë amendamentet e veta. Ju faleminderit!

KYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kelmendi!  
Deputetja Shpresa Murati, në emër të Grupit 6+.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!  
Pozdravljam sve prisutne,

Danas je pred nama jako značajan Nacrt zakona o završnom i maturskom ispitu. Imajući u vidu da je ova delatnost bila delimično regulisana administrativnim uredbama, bilo je potrebno sastavljanje ovog nacrta zakona koji bi u potpunosti pokrio ovu oblast. Ovim Nacrtom zakona se reguliše način organizovanja, sadržaj, uslovi, kriterijumi i procedure završnog ispita i mature na Kosovu.

Ministarstvo za obrazovanje, nauku i tehnologiju je državni autoritet odgovoran za organizovanje završnih ispita i mature, i zato saradjuje sa Državnom centralnom komisijom za maturu, Centrom za ocenjivanje, opštinskom Komisijom za obrazovanje, centralnim komisijama za testiranje, komisijama za ocenu u školama i ispitnim odborom škole.

Značaj Nacrta zakona stoji u činjenici što će maturski ispit otkloniti organizovanje prijemnih ispita na visoko obrazovnim institucijama. Za upis u ove visoke institucije, uzeće se postignuti rezultati na maturskom ispitu. Kandidatima koji završe završni ispit, izdavaće se uverenje, dok kandidatima koji završe maturski ispit izdavaće se diploma o završenoj visokoj srednjoj školi.

Ovaj Nacrt zakona je sastavljen u skladu sa Ustavnim okvirom i sa zakonodavstvom koje je u sprovodenju u zemljama Evropske zajednice. Radi se, znači, o Nacrtru zakona koji je zaista sveobuhvatan, koji detaljno reguliše pitanje iz ove oblasti, pa ga stoga Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava i veruje da će funkcionalna komisija uraditi sve da eventualne nedostatke otkloni i dobijemo zakon koji će biti sprovodljiv u praksi savremenog Kosova. Haval!

KYESUESI: Ju faleminderit, zonja Murati!  
Fjalën e ka Zylfije Hundozi.

ZYLFIE HUNDOZI: Zoti kryesues,  
Kolegë deputetë,

Me këtë Projektligj do të faktorizohet provimi përfundimtar dhe ai i maturës dhe në të ardhmen do të jetë bazë për regjistrimin në fakultet pa provime pranuese. Kjo është shumë e dobishme për kandidatët që do të registrohen në universitete private. Nëse merret parasysh se në këto universitete janë regjistruar nxënës, disa prej tyre që nuk e kanë kryer shkollën e mesme gjë fund. Mirëpo, qëllimi i hartimit të këtij Projektligji i referohet jotransparentës dhe intervenimeve për raste individuale gjatë regjistrimit në fakultete publike, por askund në Projektligj nuk është bërë hulumtimi dhe vlerësimi real i këtyre dukurive negative. Sa janë këto, 0,5%, 1%, 90% dhe a nuk është dashur të bëhet vlerësimi real dhe hulumtimi për një problem para se të vendoset të ndërmerrten masat siç janë: hartimi i një projektligji të tërë, e jo të bazohen ne thashetheme, të cilat kryesisht kanë dalë nga ata persona të cilët nuk e kanë dhënë provimin pranues. A do të jetë kjo

mënyrë më e mirë që t'u iket vështirësive dhe keqpërdorimeve të supozuara që kanë ekzistuar gjatë regjistrimeve në fakultet, do ta tregojë koha, meqenëse qysh tani vërehen shumë mangësi. Më së pari, askund në Projektligj nuk është e caktuar, cekur pagesa e komisioneve. Nga eksperiencia me komisionet e formuara nga ana e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, të cilat nuk janë paguar kur për punën e bërë, dimë që ato pas një kohe nuk e kanë kryer punën e tyre ose kanë gjetur mënyra alternative të vetëfinancimit, gjegjësisht të paguhën nga palët e interesuara që t'iu kryhet puna. Me fjalë të tjera, janë korruptuar.

Nëse kjo ndodhë me këto komisione, atëherë jo vetëm që do të humbet qëllimi që të bëhet vlerësimi sa më i mirë dhe real i dijes, por edhe do të degradohet edhe ai kriter që ka ekzistuar për provime pranuese në fakultet.

Përfshirja e një numri të madh të strukturave për organizimin dhe kryerjen e këtyre dy provimeve, siç është Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës, Qendra e vlerësimit, drejtori të komunale të arsimit, komisionet e shkollave, komisionet vlerësuese, administrueshit dhe vëzhguesit e bëjnë këtë proces shumë të komplikuar dhe jo praktik dhe, për kushte tonë, të vështirë. Sa më praktike të janë gjërat, të kryera në mënyrë të mençme, do të kursejmë kohë, para dhe do të janë të suksesshme.

Disa prej këtyre strukturave nuk janë ende të krijuara, prandaj e lus Ministrinë e Arsimit që ta rishqyrtojë edhe një herë këtë Projektligj dhe ta bëjë në bazë të vlerësimeve paraprake të bazuara shkencërisht dhe të fillojë ta zbatojë atëherë kur e tërë infrastruktura të jetë e gatshme. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zonja Hundozi!  
Fjalën e ka Jonuz Ksatri.

**JONUZ KASTRATI:** Ju faleminderit, i nderuar kryesues!  
Zëvendëskryeministër, zëvendësministër,  
Kolegë deputetë dhe të pranishëm të tjerë në sallë,

Gjatë leximit dhe përpunimit të këtij Projektligji vërejtja se nuk është i paraqitur Grupi punues. Këtë po e them, edhe pse në një mënyrë është thënë disa here që duhet të paraqitet dhe është obligim që të paraqitet. Dihet se kush janë ata që e kanë punuar Projektligjin, por në këtë rast konkret dëshiroj të dijë, nëse në këtë grup kishte njerëz të cilët drejtpërdrejt këto vite janë të përfaqësuar dhe janë ballafaquar me këto procese në arsim.

Me qenë se nga kolegët, nga grupet parlamentare dhe deputetët u thanë shumë gjëra, do të ndalem vetëm në dy-tri vërejtje konkrete. Në nenin 17, pika 5 - pagesa për hyrje, me qenë se këtu është lënë mundësi për ndryshim me vendim të ministrit, kisha propozuar që të jetë 5 euro, meqenëse pagesa dy herë nga 10 euro do të jetë sigurisht një barrë e rëndë për kandidatë.

Në nenin 19, te kriteret, përmendet këtu pragu i kalueshmërisë 40%. Ata që janë në rrjedha të drejtpërdrejta e dinë që në dy vitet e fundit, edhe pse ishte pragu 40, Ministrisë i është dashur ta zgresë këtë prag në 35%, nga se kishte mbetur një numër i madh i kandidatëve nën këtë prag. Duke pasur parasysh realitetin, kohën dhe nivelin në

të cilën ende jemi, pasi që edhe zyrtarisht është vepruar kështu qe dy vite, kisha propozuar që pragu të jetë, të paktën edhe në letër, 35%.

Sa i përket nenit 23, ku thuhet se provimi i maturës do të zgjasë 4 orë, ata që kanë punuar në këtë drejtim e dinë se afatet qershorit dhe të gushtit mbahen në një mot shumë të nxehët, unë konsideroj se është kohë shumë e gjatë. Në këto dy vite të fundit që kemi punuar, koha ka qenë 3 orë, prandaj propozoj që të jetë prapë e njëjtë, 3 orë.

Sa i përket nenit 31 që ka të bëjë me certifikata e diploma, është mirë që të qartësohet këtu çështja e certifikatave dhe e diplomave që merren për shkolla trevjeçare dhe ato katërvjeçare. Në këtë vit për shkollat trevjeçare ato quhen certifikata, ndërsa për të tjerat diploma. Kjo duhet të qartësohet këtu edhe kur është fjala për gjimnazin e përgjithshëm 13 vjeçar. Kishte kërkosë edhe në Ministri që në një mënyrë të dallohen këto, prandaj edhe po kërkoi që të qartësohen këto. Sa i përket afatit të jashtëzakonshëm, ndoshta do të kishte qenë mirë që në ndonjë mënyrë të përmendet edhe afati i janarit për të vetmen arsyet që të shkarkohet ngarkesa e afateve të rregullta të qershorit me kandidatë të cilët vijnë nga afati paraprak. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMAITI: Ju faleminderit, zoti Kastrati!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIJAJ: Inderuari zoti kryesues, Sabri Hamiti!

Inderuari zëvendëskryeministër,

Të respektuar deputetë dhe ju që i përcillni punimet e kësaj seance,

Shqyrtimin e parë të Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës, sot në këtë seancë të Parlamentit të Kosovës, e vlerësoj një të arritur të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës e të Teknologjisë, se reforma në arsim edhe në këtë fushë veprimtarie rregullohet me infrastrukturë ligjore për herë të parë, përmes të cilës mundësohet organizimi dhe mbajtja e provimit përfundimtar dhe të maturës me standardet e larta bashkëkohore.

Jetësimi i këtij Projektligji vlerësoj se nxitë angazhimin maksimal të mësimdhënësve dhe të nxënësve për zotërimin e objektivave të përcaktuara në programet shkolllore, ngase që në start e kanë të qartë se provimi përfundimtar është kurorëzim i përpjekjeve pëngritjen e nivelit arsimor me të cilin verifikohet arritshmëria në mësim.

Projektligji definon obligimet dhe përgjegjësitë e shumë subjekteve të arsimit dhe të individëve të cilët janë përgjegjës për kurorëzimin me sukses të punës për mbajtjen e provimit përfundimtar dhe të maturës, duke hequr dilemat rreth padrejtësive, duke krijuar kushte mundësi që provimi i maturës të organizohet në shkallën më të lartë të transparencës dhe pa ndërhyrje anash përmes testit unik dhe të standardizuar për Kosovën. Me këtë rast do të veçoja, a thua testi unik duhet të jetë për tërë shkollat e Kosovës i njëjtë, kur dihet se standardet dhe mësimdhënia dhe mësimnxënia në të gjitha shkollat e Kosovës, nuk është për momentin çdo kund njëjtë. Kriteret e përcaktuara me këtë Projektligj për vlerësimin përfundimtar të arritshmërisë së nxënësit që i përbëjnë 40% rezultatet e arritura gjatë shkollimit të mesëm, vlerësimi i brendshëm, dhe 60% rezultatet e arritura nga provimi i maturës, vlerësim i jashtëm për kalueshmëri, hapë rrugën drejt shkollimit universitar. Provimi i maturës do të jetë bazë për regjistrim në universitet. Me këtë rast, është e paqartë a do ta kenë fatin të gjithë nxënësit ta

marrin indeksin e Universitetit Publik të Kosovës dhe cilat janë kriteret për sistematizimin e tyre në Universitet. Me këtë rast do të potencoja mos po i cenohet e drejta elementare të riut për të zgjedhur rrugën e dëshiruar profesionale. Projektligji është i hartuar mirë dhe në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian. Për herë të parë po e miratojmë një ligj, që me participimin e nxënësit do të lehtësojë punën organizative të këtyre dy provimeve nga Ministria e Arsimit.

Projektligjin e përkrah në parim me shpresë që gjatë amendamentimit, të evitohen paqartësitë lidhur me definimin e obligimeve dhe të përgjegjësive të mekanizmave që organizojnë e mbajnë provimin përfundimtar dhe të maturës. Ju faleminderit!

**KRYESUESI SABRI HAMITI:** Të gjithë deputetët, që janë paraqitur të diskutojnë në parim për këtë ligj, e kanë marrë fjalën. Tash, i thërras ata që janë jashtë që të hyjnë në sallë, dhe më lejoni që edhe unë t'i jap dy-tri komente.

U pa që jemi shumë produktiv rrëth kësaj teme, se si duket edhe në Qeveri kemi shumë mësues, edhe në Parlament sa të doni. Mendoj që Ligji është i domosdoshëm dhe është një nga ligjet më të nevojshme për shkollën tonë, sepse përmes tij bëhet direkt ajo që ne e quajmë reformë, konkretisht.

Pati vërejtje në pikë të veçanta dhe ka mundësi që ato të ndreqen, por disa gjëra janë universale dhe unë besoj që, pa marrë parasysh që u përmendën, dihet që janë ashtu. Para ligjit janë të barabarta në këtë rast edhe shkollat private, edhe ato publike, sepse kjo është normë shtetërore. Matura pretendon që të krijojë variacione të degëve, prandaj kjo maturë do t'i orientojë edhe njerëzit ku janë më të fortit, të studiojnë atje ku janë më të përgatitur dhe në këtë kuptim, ky Ligj e bën reale reformën. Sa për punën organizative, unë dëgjova disa here vërejtjeje, sidomos kolegu Ramadani tha burokratizim, burokratizim e të tjera, e të tjera. Paj, burokratizim janë ato sende, tjetër nuk munden të jenë. Kini kujdes, nuk ka asgjë ideale. 20.000 vetë janë në një sallë, një kozmodrom nuk mund të ndërtohet, prandaj do të krijohen salla me kushte të përafërtë që të provohet testi i njëjtë. Kjo është me rëndësi. Nuk ka shans të bëhet ndryshe. Me rëndësi është që testi të jetë i njëjtë. Unë edhe njëherë po them për vete, mendoj që është një ligj i cili tenton që reformën ta bëjë vepër. Prandaj, unë për vete e mirëpres dhe e votoj me kënaqësi. Ju thërras edhe juve të votojmë. Përgatituni, votojmë tash:

Me 67 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim, miratohet në leximin e parë Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon për punë të mëtejshme këto komisione:

- Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision funksional dhe raportues,
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
- Komisionin për Komunitete.

Kalojmë në pikën e katërt të rendi të ditës, sepse tanimë e kemi të pranishëm referuesin, zëvendësministrin:

## **- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin Bujqësor**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6 shtator 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

E ftoj zëvendësministrin Tomë Hajdaraj, që në emër të Qeverisë së Kosovës ta paraqesë Projektligjin para deputetëve. Urdhëro, zoti zëvendës!

**TOMË HAJDARAJ:** Ju Faleminderit, zoti kryesues,

Zoti zëvendës kryeministër

Të nderuar deputetë,

Para jush sot paraqesim Projektligjin për Inspeksionin bujqësor, i cili është një ligj i natyrës së punës të veçantë sepse ka të bëjë me pjesë ekzekutive dhe me implementimin e ligjeve të tjera të miratuar në këtë Kuvend.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është krijimi i kornizës së domosdoshme ligjore të inspektimit në fushat e bujqësisë, të pylltarisë, të gjuetisë, të mbrojtjes së bimëve, të blektorisë dhe të peshkatarisë e veterinës. Çështjet kryesore të cilat i rregullon ky projektligj janë të renditura në shtatë kapituj, duke u nisur nga dispozitat e përgjithshme deri te ato përfundimtare, dhe janë të parashtruara në kapituj të veçantë, por të harmonizuara me kriteret e Bashkësisë Evropiane, duke pasur parasysh gjithnjë edhe specifikat për Kosovën.

Rëndësia e këtij projektligji, konsiston në krijimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje inspektuese, në zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore për personat juridikë, personat fizikë, personat e tjerë në ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Këtu ka edhe disa risi të krahasuara me ligjin i cili ishte në fuqi, do të thotë 32/76, sepse konsiston në organizimin e qëndrueshmë funksional të inspektorëve gjatë mbikëqyrjes inspektuese. Sa i përket harmonizimit në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës, ky Projektligj është në përputhje me nenin 36 të Rregullore së punës, pastaj sa i përket harmonizimit të Projektligjit me standarde legjislacionit të BE-së, thashë se është e harmonizuar. Shpenzime gjatë hartimit nuk kemi pasur. Gjithashtu, edhe gjatë implementimit të këtij ligji nuk do të kemi shpenzime buxhetore. Janë të krijuar trupat ekzekutiv të të dyja niveleve: të nivelit qendror dhe të atij komunal. Andaj, deputetë të nderuar, ju ftoj që ta miratoni në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti zëvendësministër!

Deputeti Shaban Halimi, flet për Ligjin në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

**SHABAN HALIMI:** I nderuari zoti kryesues,

Zoti zëvendëskryeministër,

Zoti ministër.

Të nderuar kolegë e kolege deputetë e ju të tjerë të pranishëm,

Për rolin dhe rëndësinë e Ligjit që ka për Inspeksionin e Bujqësisë pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Pylltarisë, foli edhe vetë zëvendësministri. Ne, si anëtarë të komisionit funksional pranë Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kemi shqyrtuar këtë Projektligj dhe kemi parë se ky projektligj është në përbajtje i mirë, është i normuar

mirë, këtë materie e rregullon mirë dhe kemi vendosur që t’ia japim votën tonë pro këtij Ligji në lexim të parë.

Sigurisht, se si anëtarë të Komisionit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike do të japim ndihmesën tonë në komisionin funksional, që ky ligj të jetë edhe më i kompletuar dhe më cilësor në aspektin e funksionalitetit të tij. Kjo do të ishte e tëra nga ana ime. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Halimi!  
Deputeti Xhelal Canziba, për Grupin Parlamentar të PDK-së.

**XHELAL CANZIBA:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Inderuari zëvendëskryeministër,  
Inderuari zëvendësministër,  
Kolegë deputetë të nderuar,

Me këtë Ligj rregullohet puna, kompetenca, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit. Bujqësia tradicionalisht ka qenë një ndër sektorët më të rëndësishëm në Kosovë. Sot bujqësia është lënë pas dore, dhe shumica e prodhimeve bujqësore importohen nga jashtë. Edhe pse ka shumë çështje të hapura, kushtet për zhvillimin e bujqësisë janë të favorshme në Kosovë.

Duke pasur parasysh se bujqësia është një nga sektorët kryesor për rritjen ekonomike, gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin, duhet të kemi të quartë të gjithë se pa një bujqësi të zhvilluar nuk do të ketë as ekonomi të zhvilluar.

Ringjallja e sektorit të bujqësisë në Kosovë varet shumë nga përkrahja e Qeverisë së Kosovës, e cila duhet ta rrisë buxhetin për Ministrinë e Bujqësisë, në mënyrë që e fundit të mbështesë prodhuesit vendorë, kur dihet se gjysma e popullsisë jetojnë në vise rurale, të cilat bujqësinë e kanë të vetmin burim jetese. Me stimulimin e bujqve për prodhim, krijohen mundësítë për rritje të eksportit, si dhe zvogëlon importin që aktualisht është shumë i madh.

Efektet negative dhe pasojat e pariparueshme për ekonominë e Kosovës, e sidomos për të ardhmen e saj, do të ndihen sidomos nga ndërtimet të cilat pamundësojnë shfrytëzimin e tokës bujqësore për qëllime bujqësore të bonitetit të lartë.

Mbrojtja e tokës bujqësore nëpërmes krijimit dhe zhvillimit të legjislacionit dhe mekanizmave të tjera, të nevojshëm dhe të domosdoshëm përmes një koordinimi më të përgjegjshëm institucional në kohën e gllabërimit të tokës bujqësore, është më tepër se interes për Kosovën. Vështirësitë e inspektimit dhe të mbikëqyrjes inspektuese nga inspektorët e bujqësisë, shpeshherë ngatérrojnë kompetencat me ministritë e tjera, nga aftësia dhe neglizhenca e kuvendeve komunale, vetëdija e ulët dhe disiplina e qytetareve në dëm të tokës bujqësore, sipas destinimit të saj dhe politikës së mbrojtjes të tokës bujqësore.

Reagimi institucional duhet të jetë i shpejtë, efikas dhe adekuat konform dispozitave ligjore dhe gjendjes faktike. Interpretimi apo keqinterpretimi i dispozitave ligjore dhe i akteve të tjera nënligjore nga aspekti juridik e praktik, është një pjesë e errët e këtij realiteti të Kosovës sa i përket tokës bujqësore dhe shfrytëzimit të saj konform dispozitave ligjore.

Krijimi i vetëdijes kombëtare dhe qytetare, si dhe të vetë disiplinës qytetare dhe juridike, në interes të shfrytëzimit të tokës bujqësore, sipas destinimit të saj për prodhimtarinë bujqësore, në pajtim me dispozitat juridike dhe koordinimin institucional si në rrafshin horizontal, ashtu edhe në atë vertikal, janë të nevojshëm dhe të domosdoshëm për shkak të humbjes dhe të dëmtimit të tokës bujqësore, dhe të shumë faktorëve dhe rr Ethanave, nëpër të cilat po kalon sot Kosova.

Nëpër këtë fazë tranzicioni të përcjellë me shumë probleme dhe vështirësi të natyrës objektive dhe subjektive, të cilat reflektohen edhe në shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe me pasojat, të cilat janë të papërmirësueshme për ekonominë e Kosovës, e cila është në fazën e përshtatjes së ekonomisë së tregut dhe të përafrimit të legjislacionit me atë Bashkimit Evropian.

Lehtësimet nga Qeveria përmes subvencionimit të prodhimeve bujqësore, politikat fiskale, krijimi i kushteve për politikë investive në bujqësi, me kushte dhe kamata të volitshme, do të ndikonin pozitivisht edhe në shfrytëzimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore.

Kompletimi i Kornizës ligjore, zhvillimi dhe perfeksionimi i mëtejshëm i ligjeve janë në funksion të ndryshimit të rr Ethanave për funksionalitet dhe realitet të ri të kriuar. Me përgjegjësi të përbashkët, që shprehet përmes koordinimit institucional, jo vetëm të Ministrisë së Bujqësisë, të ministritë të tjera, të komunave, po edhe të të gjitha akteve relevante që mund të kenë ndikim pozitiv, duke përfshirë edhe mjetet e informimit. Krijimi, zhvillimi dhe forcimi i vetëdijes qytetare dhe juridike për shfrytëzimin e tokës bujqësore, duhet të jetë në pajtim me dispozitat ligjore dhe në pajtim me destinimin e tokës bujqësore. Vetëm për qëllime dhe nevoja bujqësore, është i domosdoshëm dhe i nevojshëm. Roli dhe rëndësia e politikës ndëshkimore adekuate, në detyrimet që dalin nga shfrytëzimi i kundërligjshëm i tokës bujqësore, është mjeti i fundit, por i domosdoshëm dhe i nevojshëm dhe këtu padyshim roli i gjykatave si institucionet duhet të jetë i domosdoshëm në dënimin e shkeljeve të ligjit.

Ndryshimi i rr Ethanave ekonomiko-politike në Kosovë, determinon nevojën e ndërrimit të punës, të shfrytëzimit tradicional të tokës bujqësore, e cila shfrytëzohet kryesisht sa për të plotësuar nevojat e ngushta familjare, ndërkohë që duhet të ndryshojmë edhe më tepër këtë mënyrë të shfrytëzimit të tokës bujqësore për agrobiznes. Kjo është inkurajuese, sepse tani ka filluar të ndërrohet kjo vetëdije e kriuar më parë, në të menduarit dhe të kuptuarit e shfrytëzimit të tokës bujqësore për agrobiznes.

Projektligji për Inspeksionin Bujqësor ka edhe shpenzime shtesë. Këtu kemi nenin 11 ku bashkëpunimi dhe koordinimi mes inspektorëve të ministrisë dhe të kuvendeve komunale, nuk rregullohet me këtë ligj. Në këtë ligj thuhet se: "Bashkëpunimi dhe koordinimi rregullohet me dispozitat ligjore", por nuk thuhet se me cilat dispozita ligjore rregullohet, nëse jo me dispozitat e këtij ligji.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Canziba.

Deputeti Xhevdet Neziraj, besoj në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Inderuar kryesues i seancës, akademik Hamiti,

Inderuar zëvendësministër,

Tënderuar kolegë deputetë,

Me Projektligjin për Inspeksionin Bujqësor krijohet një bazë ligjore për inspektim në fushat me rëndësi në bujqësi, si degë shumë e rëndësishme e ekonomisë.

Projektligji rregullon çështje të rëndësishme dhe me prioritet për të siguruar inspektim të qëndrueshëm në zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore gjatë veprimtarisë së personave juridikë dhe fizikë nga fusha e bujqësisë. Me këtë Projektligj do të inspektohen fushat e bujqësisë, të pylltarisë dhe të gjuetisë, mbrojtjen e bimëve, të blektorisë dhe të peshkatarisë si dhe inspektimin në lëmin e veterinës. Ky Ligj ka mbështetjen në ligjet në fuqi, në lëmin e bujqësisë, të pylltarisë dhe të zhvillimit rural të mbështetur në legjislacionin e BE-së.

Kjo fushë deri me tani është rregulluar me ligjet e aplikueshme në Kosovë, e bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut, 1999/14. Projektligji rregullon dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspeksionit në ato fusha të cekura më lart. Vërejtje do të kisha te neni 29, ku dispozitat ndëshkimore është mirë të caktohen për arsyen se në gjykatat për kundërvajtje po kemi pengesa në shqiptimet e dënimive, dhe te aktet nënligjore.

Ne si Komision për Ekonomi, dje ishim në vizitë në Komunën e Podujevës, dhe më vjen keq që këtu nuk është zëvendësministri Lutfi Haziri. Shumë akte nënligjore të ministrit nuk shkojnë nëpër komuna dhe kështu ligjet mbresin të pazbatueshme. Presim që aktet nënligjore nga Ministria e Bujqësisë të mbërrijnë me kohë në komuna dhe të zbatohen.

Në fund, Grupi Parlamentar i AAK-së, me IRDK-në përkrahim këtë Projektligj dhe do të kontribuojmë në leximin e dytë dhe nëpër komisione ku do të shqyrtohet Projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Neziraj!

Mahir Yagcilar, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Sayın Başkanvekili

Sayın Bakanvekili,

Değerli Milletvekilleri

Önerilen Yasa, bir yandan insanların yaşamı ile sağlığının, hayvanların ve kamu çıkarın korunması, diğer yandan da Mecliste onaylanan yasaların uygulanması yönünde önemi büyüktür. Öyle ki, yasaların uygulanması için Mütetişle ayit yapılması yasanın bir şekilde gerekli bulunmaktadır Mütetişlik sayesinde, bu tasarıının başında belirtilen alanlarla ilgili ticaretin yasamacılığına ve işadamının muamele edilmesine karşı denetim yapılmaktadır. Sözkonusu tasarıının 15. maddesiyle, özellikle 16. maddesiyle öngörüldüğüne göre, müfettişin uzmansal enstitülerle yapması gereken işbirliği çerçevesinde, bazı engellerin beliriverdiği olaylarda müfettişin polis hizmetinden yardım isteyebileceğile ilgili paragraf yeterli değildir, bundan ötür de bu paragrafta Polis Hizmetinin müfettişle yardım sunmasının zorunlu olduğu işaret edilmelidir. Aynı zamanda 11. maddede de eksiklik görülmektedir, bu maddede, Bakanlığa ait tarım

müfettişlerinin belediye müfettişleriyle işbirliği yapması gereken ayrıntılarla belirtilmemiş, sadece yasal hükümlerle düzenlendiğine işaret edilmektedir, bu hükümlerin hangileri olduğu ve ne zaman onaylanacağı belli değildir. Sözkonusu Yasa Tasarısının görüşülmesi sırasında Komisyonlar tarafından bu eksiklikler herhalde gözönünde bulundurulacaktır. Dolaysıyla grup olarak Yasa Tasarısını prensipte desteklediğimizi ifade ederek saygılarımı sunarım.

Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Yagcilar!  
Kolegu Gazmend Muhaxheri në emër të Grupit ORA.

GAZMEND MUHAXHERI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar ORA japim mbështetje që ky Ligj të kalojë në lexim të parë, mirëpo shprehim dyshimin se në kohën e etheve parazgjedhore që e ka përfshirë Parlamentin, Komisioni Parlamentar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, do të jetë në gjendje t'i sqarojë paqartësitë të cilat e karakterizojnë këtë ligj në tri nene. Dyshoj shumë që do të mund të zgjidhet paqartësia në nenin 11, e cila ka të bëjë me bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet Inspeksionit Bujqësor të Ministrisë së Bujqësisë dhe Inspeksionit Komunal, sepse nuk dihet se me çfarë dispozitash ligjore do ta rregullojë këtë çështje Komisioni, kur nuk ka mund ta zgjidhë këtë çështje Ministria me ekspertët që i ka pasur në dispozicion. Dhe, shpreh dyshimin që nenin 4.3, i cili rregullon punën e inspektorëve, e cila duhet të kryhet vetëm nga personat që posedojnë përgatitje superiore, do të jetë Komisioni në gjendje të përcaktojë se cilët janë ata persona që kanë përgatitje superiore.

Me shpresë se ndoshta do të kemi ndihmën e ekspertëve të Ministrisë për t'i qartësuar këto çështje, i japim përkrahje këtij Projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Muhaxheri!  
Zonja Besa Gaxherri në emër të LDD-së.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar kolegë deputetë,  
I nderuari zoti zëvendësministër, Hajdari,

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka inspektimi në përgjegjësinë e një organizimi shoqëror, na vjen mirë që sot po shqyrtojmë Projektligjin për Inspeksionin Bujqësor, që pretendon që këtë fushë të veprimit kaq të rëndësishme ta sanksionojë me ligj.

Ne mendojmë se Projektligji është i hartuar relativisht mirë, me një strukturë të mirë dhe nuk dua sot t'ju marrë kohë kolegëve dhe t'i përsërisë vërejtjet që i bënë kolegët në strukturimin e këtij ligji, por unë mendoj se Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, e mbështet në lexim të parë këtë Projektligj, dhe natyrisht, kontributin tonë do ta japim përmes komisioneve funksionale. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Gaxherri!  
Zoti Ferid Agani, në emër të Grupit për Integrime.

FERID AGANI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar për Integrim e mbështet Projektligjin në parim, duke mos i përsëritur kualifikimet pozitive që u bënë.

E kam vetëm një vërejtje përmbajtjesore, që ka të bëjë me titullin e Projektligjit. Këtu thuhet se bëhet fjalë për Projektligjin për Inspeksionin Bujqësor, ndërsa nga teksti i Projektligjit shihet shumë qartë se në të vërtet bëhet fjalë për pesë lloje të veçanta të inspektorateve, do të thotë të inspeksioneve: për bujqësi, për pylltari, për gjeti, për inspeksionin fito-sanitar, për blegtori, peshkatari dhe veterinari. Prandaj, mendoj se komisionit funksional i mbetet të gjiej zgjidhjen, të cilën propozuesi i Projektligjit nuk ka arritur ta gjiej. Konkrektisht mund të shihni në nenin 4, kur numërohen pjesët e inspeksionit që është dashur të jetë: "inspeksi bujqësor", kurse thuhet: "inspeksi përbëhet nga". Normalisht, sepse është kundërshtim logik. Prandaj, mendoj se me këtë ndryshim në titullin e Projektligjit, ky projektligji mund të kalojë në parim në Kuvend sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI : Ju faleminderit, zoti Agani!

Nuk ka më deputetë të tjerë që dëshirojnë të flasin për këtë projektligj, prandaj ju thërras të bëheni gati ta votojmë, në parim.

Votojmë tash:

Në sallë janë të pranishëm 66 deputetë. "Për" votojnë 60 deputet, "kundër" janë 2 deputetë, kurse 1 abstenon.

Konstatoj se u miratua Projektligji në lexim të parë, në parim.

Në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi dhe Mjedis, si komision funksional dhe raportues;
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese;
  - Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe
  - Komisionin për Komunitete.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit pë regjistrat e statusit civil**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 31 maj 2007.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit pë regjistrat e statusit civil ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit pë regjistrat e statusit civil nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimit dhe Ligjit për registrat e statusit civil nuk përbajnjë implikime buxhetore.

Atëherë, do të vazhdojmë me procedim. Fjalën e ka kërkuar deputetja, Nekibe Kelmendi.

**NEKIBE KELMENDI:** Në emër të Komisionit Funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, e ndiej për obligim të jap një sqarim paraprak para se të votohen amendamentet për këtë ligj.

Ne, këtu para vetës kemi radhitjen e rekomandimeve të amendamenteve në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për registrat e statusit civil, që do të thotë se përpara ka ekzistuar një ligj për këtë dhe tash bëhet ndryshimi. Ligji i mëparshëm ka qenë miratuar më 21 tetor 2004 dhe ka pasur emërtimin: "Ligji për registrat e statusit civil" Mirëpo, kur është shpallur nga Përfaqësuesi Special, me Rregulloren 2005/21, është ndryshuar titulli i Projektligjit, i ligjit të atëhershëm dhe në vend të fjalës: "statusi civil", është përdorur fjala: "gjendja civile". Qeveria përsëri e ka proceduar në Parlament Projektligjin për registrat e statusit civil e jo sikur që ka ndërhyrë PSSP-ja dhe e ka ndryshuar fjalën "status" me fjalën "gjendje". Prandaj, ne kemi shkuar me atë çka na ka thënë Qeveria, sepse me këtë titull është miratuar në lexim të parë dhe me këtë titull edhe do të shkojmë.

Edhe një sqarim tjeter. Ndryshimet që do t'i shihni në amendament, nuk kanë të bëjnë me Ligjin e atëhershëm 2004/46, por kanë të bëjnë pikërisht me këtë projektligj. Ju faleminderit!

**KRYESUESI :** Ju faleminderit, zonja Kelmendi!  
Procedojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për.....54, kundër..... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 60, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 55, kundër..... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 53, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për.....54, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 46, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 58, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Ju njoftoj që 63 deputetë janë në sallë.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për..... 55, kundër.....2.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 57, kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për..... 54, kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për.....52, kundër.....0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Për.....57, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për..... 54, kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Për..... 49, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 55, kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Për..... 47, kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Për..... 52, Kundër.....1.

Miratohet amendamenti.

Si po shihet, deputetët janë duke u larguar, tani jemi 57.

Unë ju thërras që të vini e të votoni!

Më duhet t'ju them se shumica jeni nëpër ato lista të votimit. Mbani në mend se ju po konkurroni prapë. Jeni nëpër lista të gjithë, edhe para opinionit edhe para vetës. Le të dihet se po dilni nëpër korridore, por ktheheni dhe votoni. Kaq!

Unë ju pres të ktheheni dhe të votoni.

Pauzë nuk ka, jemi në procedurë të votimit. Ktheheni dhe votoni!

Të pranishëm në sallë janë vetëm 57 deputetë. Na duhen edhe katër veta për të vazhduar. Le të kthehen, sepse do të votojmë. Hydajet Hyseni, është këtu.

Ju lutem, kemi hyrë në votim, nuk ka pauzë.

Urdhëro! Jo – jo, s'po e merr fjalën! Asgjë nuk kam thënë.

Unë vetëm ju kam ftuar të ktheheni.

Po, edhe do të ishte mirë t'ju thërras me emër. Është detyrë t'ju thërras me emër.

Tani janë 58. Do të kisha thënë, dil në korridor, shiko a janë aty!

Po, duket se aty janë, por edhe ndoshta nuk shihen, janë pështjellë diku andej.

Ju lutem, duhet të kuptoni se jemi në fazën e votimit.

(Ndërprerje - Pritet që të kthehen deputetët në sallë)

Tani, mund të vazhdojmë me votim.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Për..... 60, kundër..... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për..... 57, kundër.....0.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 20

Votojmë tash:  
Për.....56, kundër..... 1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 21  
Votojmë tash:  
Për..... 53, kundër..... 1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 22  
Votojmë tash:  
Për..... 61, kundër..... 1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 23  
Votojmë tash:  
Për..... 61, kundër.....1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 24  
Votojmë tash:  
Për..... 59, kundër.....1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 25  
Votojmë tash:  
Për..... 55, kundër..... 0.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 26  
Votojmë tash:  
Për..... 61, kundër..... 0.  
Miratohet amendamenti

Amendamenti 27  
Votojmë tash:  
Për..... 58, kundër.....1.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 28  
Votojmë tash:  
Për..... 59, kundër..... 1.  
Miratohet amendamenti

Amendamenti 29  
Votojmë tash:  
Për.....49, kundër..... 0.  
Miratohet amendamenti.

Amendamenti i fundit nr. 30

Votojmë tash:

Për.....53, kundër..... 0.

Miratohet amendamenti.

Ju lutemi, tash votojmë Ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Kuorumin e kemi.  
Votojmë tash:

Me 63 vota “për” dhe asnjë “kundër” u miratua Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil.

Unë tash po ju drejtohem, se po e shoh që jeni lodhur shumë. Unë mendoj se duhet vazhduar punën, por do të jap një pushim.

Ne do të punojmë, kuvend është ky. Nuk ka arsyë të mos punojmë. Unë propozoj një pushim prej 20 minutash dhe pastaj të vazhdojmë punën.

(Pas pushimit, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI:

Kolegë të nderuar,

Duhet të kemi kuorum të nevojshëm për të vazhduar punën.

Në radhë është pika e nëntë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin civil**

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 31 maj 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet e veta, si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për statusin civil ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për statusin civil nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për statusin civil nuk përbajnjë implikime buxhetore.

Në vazhdim do të procedojmë me shqyrtimin e amendamenteve një nga një, sipas radhitjes:

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për.....54, kundër.....0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 2

Votojmë tash:

Për.....56, kundër..... 1

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 3

Votojmë tash:

Për.....53, kundër ..... 1

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 4

Votojmë tash:

Për.....57, kundër..... 1

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 5

Votojmë tash:

Për.....59 kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 6

Votojmë tash:

Për.....60, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti nr. 7

Votojmë tash.

Për.....52, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për.....59, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për.....47, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për.....59, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash.

Për.....56, kundër..... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Për..... 53, kundër.....2

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për..... 52, kundër....0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Për..... 52, kundër.... 0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 51, kundër....0

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Fjalën e kérkon Hydajet Hyseni. Urdhëroni!

**HYDAJET HYSENI:** Kjo çështje lidhet edhe me vërejtjen që ishte paraprakisht për “statusin martesor të qytetarit”, që u zëvendësua me “statusin martesor të personit.”

Unë kisha ndërmend të propozoj që të jetë vetëm “statusi martesor”

Ne kemi luftuar që ta kemi në legjislacionin tonë nocionin “qytetari” dhe nuk mund të fshihet lehtë, por tani e kemi edhe një kontradiktë. Atje u ndryshua e këtu është “statusi i qytetarit.”

Unë mendoj, megjithatë, që për t'i hequr komplikimet, është mirë të flitet për statusin martesor, për gjendjen civile dhe nënkuptohet qysh është për banorët, për qytetarët, është edhe për ata që nuk e kanë statusin, nënshtetësinë etj. dhe nuk ka nevojë të thuhet fare: qytetarëve, banorëve ose personave. Ju faleminderit!

